- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [ *njoftimin e kontratës* ].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 4.**

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit****Nënshkrimi****Vula**


**Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

**Ndërtim Pusi i ri Nr. 4 Vrion, godina dhe linja e tubacionit**

[Title]





Rish.	Qëllimi i Dorëzimit	Shënime	Data
00	Për zbatim		Janar 2024

	PERGATITI			POROSITËSI	
	Përgatiti:	Licenca:	Firma:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri:	Ing. Hidro Dritan BRATKO	Liç. K.2637/2			
Firma:	Arc. Jetlir GJERGJI	Liç. A.1525/1			
Data:	Janar 2024	Janar 2024	Janar 2024		
Statusi i	Përfundimtar	Kontrolluar	Miratuar	Kontrolluar	Miratuar

**Sarandë 2024**

## Përmbajtja

Përmbajtja .....	i
Lista e Tabelave .....	7
Lista e Figurave .....	10
1 Hyrje .....	11
2 Detyra e projektimit .....	14
2.1.....	Vendndod
hja .....	14
2.2.....	Qell
imi .....	14
2.3.....	Te dhënat
kryesore.....	15
2.4.....	Kodet, standardet dhe dokumentet
teknike .....	15
2.4.1 Kodet.....	15
2.4.2 Standardet .....	16
3 Punimet qe do te kryhen.....	19
3.1.....	Pastrimi i
sheshit .....	19
3.2.....	Germimi per
Strukturat .....	19
3.3.....	Shtrirja e
Germimeve .....	20
3.4.....	Germimi i Materialit te
Dobet .....	21
3.5.....	Shkarkimi i Materialit te tepert nga
germimi .....	21
3.6.....	Mbushja e
Tubacionit.....	22

---

 Error! Unknown document property name.
 

---

 Rish. Error! Unknown document property  
 name.
 

---

3.7.....	Shiriti	
Paralajmerues.....		22
3.8.....	Mbushja Perfundimtare e Kanaleve dhe	
Tubave .....		22
3.9.....	Hapja e	
Pusit.....		23
3.10.....	Testet e Ujerave	
Nëntokësore .....		24
3.11.....	Tubat dhe Pjeset prej	
Gize .....		24
3.12.....	Certifik	
atat .....		26
3.13.....	Rregull	
oret .....		26
3.14.....	Shenjat ne tuba dhe	
pajisje .....		27
3.15.....	Punime	
rrethimi.....		28
3.16.....	Po	
rtat.....		28
3.17.....	Fidane Peme Dekorative dhe Sistemimi i	
Vendndertimit .....		28
3.17.1	Dorezimet .....	28
3.17.2	Prerja e pemëve.....	28
3.17.3	Zëvendësimi i pemëve të dëmtuara.....	28
3.17.1	Koha e mbjelljes.....	28
4	Matesi i Ujit .....	29
4.1.....	MATES Uji	
Woltman.....		29
5	Pompa Zhytесе .....	32

Error! Unknown document property name.

Rish. Error! Unknown document property name.

6	Punimet e Betonit .....	34
6.1	.....Të përgjithshme .....	34
6.1.1	Referencat .....	34
6.1.2	Materialet përbërëse.....	34
6.2.3	Transporti, hedhja dhe trajtimi i betonit të sapo përgatitur .....	55
6.3	.....Procedurat e kontrollit të cilësisë .....	60
6.3.1	Të përgjithshme.....	60
6.3.2	Konrolli i prodhimit .....	60
6.4	..... Kontrolli i betonit.....	61
6.4.1	Konrolli i materialeve përbërëse, pajisjeve, procedurave të prodhimit dhe vetive të betonit	61
6.4.2	Konrolli i rezistencës në shtypje.....	62
6.4.3	Konrolli i konformitetit për rezistencën në tërheqje .....	63
6.4.4	Konrolli i konformitetit për vetitë e tjera të betonit përveç rezistencës .....	64
6.4.5	Konrolli i pajisjeve .....	69
6.4.6	Konrolli i betonit nga Kontraktori kur përdoret beton i përgatitur ne fabrika betoni .....	70
6.4.7	Konrolli i betonit në një proces prodhimi të vazhdueshëm (prodhuesit e betonit të freskët ose të parafabrikuar).....	71
6.4.8	Konrolli para betonimit .....	74
6.4.9	Konrolli gjatë transportit, hedhjes, ngjeshjes dhe trajtimit të betonit të sapo përgatitur ..	75
6.5	..... Kallëpet e betonit .....	75
6.5.1	Shtresa mbrojtëse e armaturës .....	78
6.6	..... Waterstopet (Ndaluesit e penetrimit të ujit) .....	78
6.6.1	Waterstopet PVC .....	78
6.6.2	Instalimi .....	79



Error! Unknown document property name.

Rish. Error! Unknown document property name.

6.7.....	Sipërfaqet e përfunduara të betonit .....	80
6.8.....	Llaçi – çimentos .....	80
6.9.....	Tolerancat në ndërtim .....	80
6.9.1	Struktura në tërësi.....	80
6.9.2	Themelet.....	81
6.9.3	Kolonat dhe muret.....	82
6.9.4	Trarët dhe soletat .....	83
6.9.5	Seksionet e elementeve .....	85
6.9.6	Pozicionimi i armaturës në element.....	86
6.9.7	Sipërfaqet dhe linearizimi i faqeve anësore .....	87
6.9.8	Tolerancat për vrimat (rrethore dhe katrore) dhe ankorimet .....	88
6.10.....	Fugat e ndërtimit.....	90
6.11.....	Betonet vetë – ngjeshëse (Self Compacted Concrete – SCC).....	90
6.11.1	Materialet.....	91
6.11.2	Kërkesat për betonet vetë – ngjeshëse.....	93
6.11.3	Prodhimi dhe vendosja në vend .....	96
6.11.4	Kontrolli i cilësisë .....	98
6.12.....	Kërkesat shtesë që duhet të plotësojë betoni për punime të veçanta gjeoteknike.....	98
6.12.1	Të përgjithshme.....	98
6.12.2	Përbërësit .....	99
6.12.3	Konsistenca e betonit të freskët.....	101
6.13.....	Betoni i parafabrikuar .....	101

Error! Unknown document property name.

Rish. Error! Unknown document property name.

7	Armatura e çelikut për betonin e armuar .....	103
7.1	..... Çeliku i armimit .....	103
7.2	..... Zgarat e salduara .....	104
7.3	..... Veshjet kundër ndryshkjes së armaturës .....	104
7.4	..... Armimi me fibra .....	105
7.4.1	Kriteri i identifikimit të përmbajtës së fibrave dhe homogjeniteti i betonit të freskët.....	106
8	Punimet e çelikut strukturor .....	107
8.1	..... Refere ncat .....	107
8.2	..... Çeliku strukturor .....	107
8.2.1	Vizatimet e zbatimit.....	108
8.2.2	Elektrodat .....	108
8.2.3	Prodhimi dhe montimi i punimeve të çelikut .....	108
8.2.4	Bulonat, dadot dhe rondelat .....	109
8.2.5	Saldimi .....	111
8.2.6	Provat në terren të saldimeve .....	111
8.2.7	Lyerja e punimeve të çelikut.....	112
8.2.8	Galvanizim .....	112
8.2.9	Zgarat e çelikut të galvanizuara .....	112
8.2.10	Çeliku i brinjëzuar .....	112
8.3	..... Korimanot, Shkallët e shërbimit dhe Shkallët .....	113
8.3.1	Materialet .....	113
8.3.2	Vizatimet e zbatimit të Kontraktorit.....	114

---

**Error! Unknown document property name.**

---

---

**Rish. Error! Unknown document property name.**

---

---

8.3.3	Prodhimi i punimeve të çelikut.....	114
8.3.4	Saldimi i çelikut.....	114
8.3.5	Prodhimi i korimanove .....	115
8.3.6	Prodhimi i shkallëve të shërbimit .....	115
8.3.7	Prodhimi i shkallëve.....	115
Referencat .....		153
Literatura .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>	

---

---

## Lista e Tabelave

Tabela 4-1: Te dhenat e matesve te ujit	31
Tabela 6-1: Vlerat e rekomanduara kufitare të përbërsve dhe vetitë e betonit (Tabela F.1 – EN 206)	36
Tabela 6-2: Produktet e familjes së zakonshme të çimentos (Tabela 1 – EN 197 – 1)	38
Tabela 6-3: Kufizimet në përmbajtjen e substancave shuarese në beton	41
Tabela 6-4: Agregati i trashë për beton, kërkesat e madhësisë	42
Tabela 6-5: Agregati i imët për beton, kërkesat e madhësisë	43
Tabela 6-6: Përmbajtja e klorit në beton	45
Tabela 6-7: Klasat e vetive të betonit të freskët	46
Tabela 6-8: Rekomandime për vlerat totale të synuara të përmbajtjes së ajrit në beton	48
Tabela 6-9: Zhvillimi i rezistencës së betonit në temperaturë 20°C (Tab 16 - EN 206)	49
Tabela 6-10: Vlerat limite të ujëthithjes së agregateve të betonit (të testuara sipas ASTM C 127 dhe 128)	50
Tabela 6-11: Klasat e dendësisë për betonet e lehta (Tab 14 - EN 206)	51
Tabela 6-12: Sasia e shtesave të tipit 2 dhe vlerat e koeficientit “k”	51
Tabela 6-13: Saktësia e pajisjeve matëse.	53
Tabela 6-14: Tolerancat e grumbullimit të materialeve përbërëse	54
Tabela 6-15: Koha e heqjes së kallëpeve (kur përdoret çimento e zakonshme portland)	59
Tabela 6-16: Korrigjimi i kohës së heqjes së kallëpeve për rastin e përdorimit të çimentove të tjera përveç portland të zakonshme	59
Tabela 6-17: Shkalla minimale e marrjes së mostrave për vlerësimin e konformitetit	61
Tabela 6-18: Vlerat për verifikimin e devijimeve standarde	62
Tabela 6-19: Kriteri i konfirmimit për mostrat e një familjeje betoni	63
Tabela 6-20: Kriteri i konfirmimit për rezistencën në tërheqje	64

Tabela 6-21: Vlerësimi i konformitetit për klasat e konsistencës, vetitë e SCC, përmbajtjen e ajrit dhe homogjeniteti i shpërndarjes së fibrave në betonin e freskët në momentin e dërgimit	64
Tabela 6-22: Përcaktimi i përmbajtjes së fibrave, dendësinë, raportim maksimal ujë / çimento dhe përmbajtjen minimale të çimentos	66
Tabela 6-23: Kriteret e konformitetit për vlerat e synuara a për konsistencën dhe viskozitetin	67
Tabela 6-24: Numrat e pranimit për kriteret e konformitetit të dhëna në tabelën 5.19	68
Tabela 6-25: Kontrolli i pajisjeve	69
Tabela 6-26: Kontrolli i procedurave të prodhimit dhe i vetive të betonit	71
Tabela 6-27: Sipërfaqet e kallepeve të formuara	76
Tabela 6-28: Sipërfaqet e betoneve të përfunduara	77
Tabela 6-29: Veçoritë fizike për waterstop-et PVC për fugat e ndërtimit dhe diletacionit	78
Tabela 6-30: Vlerat e devijimeve vertikale të lejuara për kolonat dhe muret	81
Tabela 6-31: Vlerat e devijimeve vertikale të lejuara për kolonat dhe muret	82
Tabela 6-32: Vlerat e devijimeve të lejuara për trarët dhe soletat	83
Tabela 6-33: Vlerat e devijimeve për seksionet e elementeve	85
Tabela 6-34: Vlerat e devijimeve për pozicionimin e armaturës	86
Tabela 6-35: Vlerat e devijimeve për pozicionimin e armaturës	87
Tabela 6-36: Vlerat e devijimeve për pozicionimin dhe përmasat e vrimave dhe tolerancat për vendosjen e bulonave dhe pllakave të ankorimit	88
Tabela 6-37: Vetit e Klasave të SCC	93
Tabela 6-38: Lista e metodave të testimit dhe vlerat tipike për vetitë e punueshmërisë së SCC	94
Tabela 6-39: Karakteristika kryesore të prodhimit të SCC	95
Tabela 6-40: Përmbajtja minimale e çimentos dhe kokerrizave të imta për betonin e pilotave të derdhura dhe të ngulura me zhvendosje	100
Tabela 6-41: Përmbajtja minimale e çimentos për betonin e mureve diafragmë	100
Tabela 6-42: Vlerat e synuara për konsistencen e betonit të freskët në kushte të ndryshme	101

Error! Unknown document property name.

---

**Error! Unknown document property name.**

---

Rish. **Error! Unknown document property name.**

---

---

---

Tabela 7-1: Kriteret e kombinuara të identifikimit të përmbajtjes së fibrave dhe homogjenitetit të betonit të freskët 106

Tabela 8-1: Bashkimet me bulona 109

Tabela 8-2: Bulonat e ankorimit të pllakave 110

Error! Unknown document property name.

---

Error! Unknown document property name.

---

Rish. Error! Unknown document property name.

---

---

---

## Lista e Figurave

Figura 1-1: Vendndodhja e objektit 11

Figura 6-1: Klasat e ekspozimit ambiental 35

## 1 Hyrje

Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarande nëpërmjet stafit mbështes te kërkuar ne AKUK dhe stafit te brendshëm ka përgatitur projektin për “Ndërtim Pusi i ri Nr. 4 Vrion, godina dhe linja e tubacionit”.

Hartimi i projektit është behet ne baze te studimit te kryer nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarande, ne kuadrin e investimeve mbi përmirësimin e furnizimit me ujë te Qytetit Bazuar ne detyrën e projektimit.

Ky Raport paraqet llogaritjet teknike te skemës hidraulike të objektit i cili ndodhet siç tregohet më poshtë:





Figura 1-1: Vendndodhja e objektit



Error! Unknown document property name.

Error! Unknown document property name.

Rish. Error! Unknown document property name.



Error! Unknown document property name.

**Error! Unknown document property name.**

Rish. **Error! Unknown document property name.**

## 2 Detyra e projektimit

### 2.1 Vendndodhja

Objekti ndodhet në Bashkinë Sarandë. Zona e studimit, stacioni i pompave Vrionit ndodhet rreth 4-5 km në lindje të qytetit të Sarandës. Ky stacion që në vitin 1988 e deri më sot, krahas burimit Navaricës furnizon me ujë të pijshëm qyteti e Sarandës. Stacioni i Vrionit shfrytëzon ujin nëntokësor të kompleksit ujëmbajtës të zhavorreve aluviale me anë të tre pus-shpimeve hidrogeologjike.

Kemi të bëjmë me zonë të ulët fushore dhe kodrinoro-malore.

Zona fushore përfaqësohet me ultësirën e fushës së Vrion-Çukë, që shtrihet nga buza e liqenit e drejt veriut deri sa mbyllet pranë kanalit Bisticës, vazhdon drejt jug-lindjes paralel me rrugën e fshatit Çukë, pikërisht në cepin jugor të Çukës. Kjo fushë aluviale shtrihet drejt veri-lindjes të fshatit dhe zgjatet drejt Vrionit dhe Finiqit. Ka gjerësi 3-5 km. Kuotat janë shumë të ulta dhe variojnë nga 3 m pranë serave dhe stallave të Çukës. Drejt bregut të Butrintit arrijnë 1-1.5 m. Në lindje të Çukës 5.5 m dhe rritet drejt Alikos nga 7.4 m deri 10.4 m. Pjesa kodrinore përbëhet nga kodra e Bredeneshit në perendim me lartësi 102.0 m mbi nivelin e detit.

Fillon me kanalin e Bistrices dhe vazhdon drejt jugut drejt Ksamilit.

Zona kodrinore më e rëndësishme është ajo e malit të Likursit me lartësi 284.7 m mbi nivelin të detit dhe fillon nga jugu i fshatit Çukë. Drejt veriut zgjatet për në qafë Gjashtë. Ka zgjatim uniform me gjerësi rreth 2 km. Kufiri perendimorë kufizohet me vijën detare, kurse zgjatimi lindor kalon paralele me lumin e Bisticë.

Nga jugu dhe perendimi vërehet një ngritje graduale me kalueshmëri mesatare, kurse nga lindja e sidomos nga veriu kemi ngritje të mënjëhershme me kalueshmëri të vështirë rrallë të pakalueshmë

### 2.2 Qellimi

Të sigurohet sasia e ujit me prurje  $Q=75$  l/s dhe rreth 6'500 m<sup>3</sup>/ditë për qytetin e Sarandës.

Përmasimi dhe rritja e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm në kohën e pikut në sezonit turistik në Qytetin e Sarandës nëpërmjet dublimit të pusit në Vrion. Furnizimi i klientëve me uje sipas Legjislacionit Shqiptar dhe dhe udhezimeve të EU. Realizimi i dublimit të pusit duke ndërtuar pusin Nr. 4V konsiston në kryerjen e disa punimeve kryesore të cilat janë:

- punime nderitmore
- punime hidromekanike
- punime rrethimi të objektit dhe sistemimi i sheshit

- punime per rrugen e aksesit
- punime elektrike
- punime per hapjen e pusit

## 2.3 Te dhënat kryesore

Zona e Vrionit është studiuar me anë të shpimeve shumë vite më parë nga Ndërmarrja e Hidrogeologjisë dhe ka rezultuar një zonë me ujëmbajtës të lartë fiziko-kimik brenda standardit të ujit të pijshëm. Nga tre pusët që ndodhen në lindje të pusi të ri merret sasia e ujit që është projektuar me nga 45-75 l/s nga secili pus. Sasia e ujit të dhënë nga pusët nuk mjafton për nevojat e pikut të sezonit, prandaj kërkohet dublim i puseve.

Aktualisht gjatë verës për shkak të rritjes së sasisë së kërkesës për ujë, qyteti i Sarandës furnizohet vetëm me 6-8 ore ujë në ditë. Kjo sasi do të reduktohej ndjeshëm mungesën në kohën e pikut.

Hartimi i projektit: “Përmirësimin e furnizimit me ujë të qytetit të Sarandës, me anë të kryerjes së një pusi shpimi të ri në zonën e stacionit të pompave vrion, Bashkia Sarandë”, sipas VKM Nr. 354 datë 11.05.2016.

## 2.4 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike

Në këtë kapitull janë dhënë kodet, standardet dhe dokumentet teknike më të rëndësishme të cilat janë ndjekur dhe respektuar gjatë procesit të projektimit.

Projektimi i të gjithë zërave sipas fushave përkatëse përmbushin kërkesat e botimeve dhe rishikimeve më të fundit të kodeve dhe standardeve të organizmave teknike të mëposhtme:

- ISO International Organisation for Standardisation
- EN European Standards
- Të gjitha kodet, normat dhe standardet shqiptare përkatëse.

Për kodet, normat dhe standardet që nuk përmenden në mënyrë specifike, projektuesi ka përdorur dokumentet përkatëse më të rrepta nga organizmat e përmendura më sipër.

### 2.4.1 Kodet

- EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor

- EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet mbi struktura
- EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave prej betoni
- EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku
- EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik
- EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit
- KTP 2-78 Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet në zona sizmike (norma teknike për projektimin në zonat sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP N.2-98 Kushtet teknike projektimi për ndërtimet antisizmike (norma teknike për projektimin e strukturave anti-sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP 4-78 Kategorizimi dhe klasifikimi i veprave hidroteknike
- KTP 7-78 Përcaktimi i ngarkesës së erës
- KTP 8-78 Përcaktimi i ngarkesës së dëborës

Në Eurokodet strukturore, kërkesat e projektimit jepen në lidhje me kushtet specifike të gjendjeve kufitare. Llogaritjet për të përcaktuar aftësinë e pjesëve të ndryshme për të përmbushur një gjendje të veçantë kufitare janë bërë duke përdorur veprimet llogaritëse (ngarkesa dhe deformime) dhe rezistencat llogaritëse. Vlerat llogaritëse janë përcaktuar nga vlerat përkatëse të veprimeve dhe rezistencat karakteristike të materialeve nëpërmjet aplikimit të faktorëve të sigurisë.

#### 2.4.2 Standardet

<b>Betoni:</b>	EN 206-1:2000/A2:2005 - Concrete: Specification, performance, production and conformity
	EN 934:2008, 2009 - Admixtures for concrete, mortar and grout
	EN 1992: 2004 - Design of concrete structures
	EN 13670: 2009 - Execution of concrete structures
<b>Çimento Portland:</b>	EN 196:2005 - Methods of testing cement
	EN 197:2000 - Cement - Composition, specifications and conformity criteria for common cements
<b>Çeliku i armimit: B500C:</b>	EN 10080: 2005 - Steel for the reinforcement of concrete

---

---

EN ISO 15630 : 2005 - Steel for the reinforcement and prestressing of concrete – Test methods

**Çeliku Strukturor: S275JR:**

EN 10025: 2004 - Hot rolled products of structural steels

EN 10210: 2006 - Hot finished structural hollow sections of non-alloy and fine grain steels

EN 10219: 2006 - Cold formed welded structural hollow sections of non-alloy and fine grain steels

EN 10034: 1993 - Structural steel I and H sections - Tolerances on shape and dimensions

EN 10056: 1993 - Structural steel equal and unequal leg angles - Tolerances on shape and dimensions

**Saldimi i Çelikut Strukturor:**

EN 1708: 2000 - Welding - Basic weld joint details in steel

EN 1011: 2003 - Welding - Recommendations for welding of metallic materials

API 1104, Specification for field welding of Pipeline

CSA Standard, W59-03, Welded Steel Construction (Metal Arc Welding)

**Bulonat dhe Kunjat:**

EN 26157 : 1991 - Fasteners - Bolts, screws and studs

EN 28839:1991 - Mechanical properties of fasteners - Bolts, screws, studs and nuts

EN ISO 4759-1:2000 - Tolerances for fasteners - Bolts, screws, studs and nuts

**Pllakat prej Çeliku dhe Zgarat:**

EN 10029: 2010 - Hot-rolled steel plates 3 mm thick or above - Tolerances on dimensions and shape

EN EN 10163: 2004 - Delivery requirements for surface condition of hot-rolled steel plates, wide flats and sections

**Standarde të ndryshme:**

- 
- 
- Ndaluesit e ujit (water stops) DIN 18541-2:1992-11 Thermoplastic water stops for sealing joints in concrete; requirements, testing, inspection
  - Galvanizimi EN 746:2000 Industrial thermoprocessing equipment - Part 4: Particular safety requirements for hot dip galvanising thermoprocessing equipment
  - Projektimi i shkallëve EN 131 : 2007 - Ladders

### 3 Punimet qe do te kryhen

Te gjitha punimet do te behen per hapjen e nje pusi te ri duke patur parasysh respektimin pikave te meposhtme:

#### 3.1 Pastrimi i sheshit

Te gjitha sheshet ku do te germohet, do te pastrohen nga te gjitha shkurret, bimet, ferrat, rrenjet e medha, plehrat dhe materiale te tjera siperfaqesore. Te gjithë keto materiale do te spostohen dhe largohen ne menyre qe te jete e pelqyeshme per zbatuesin.

Si rregull ky operacion duhet të kryhet në një shirit prej 6 metra përreth zonës ku do të kryhen punimet. Këto pargje duhet të digjen; produktet që rrjedhin nga këto operacione duhet të largohen nga zona e punës.

Duhet të përdorën pajisjet e konsideruara më të përshtatshme për këto operacione. Kontraktori duhet të shmangë dëmtimin e reperave të cilat janë të vendosura si pikënisje. Nëse ndodh shkatërrimi i objekteve të lartpërmendura, Kontraktori duhet të bëjë restaurimin e tyre.

Pastrimi përfshin pastrimin e terrenit nga të gjitha pemët, shkurret, trungjet dhe vegjetacionin tjetër dhe të gjitha mbeturinat dhe nga çdo material i padëshiruar dhe pengesa.

Gjithashtu është përfshirë heqja e të gjitha rrënjëve, përveçse nëse duhen për parandalimin e erozionit, dhe kur kërkohet, mbushja me material të përshtatshëm e të gjitha gropave të shkaktuara nga pastrimin dhe shkulja.

Poplat e izoluara dhe pengesa më të mëdha se 0.25 (një e katërta) metër kub në madhësi duhet të depozitohen në zonat e depozitimit të materialeve të tepërta dhe të materialeve të papërshtatshme të gërmuara.

Te gjitha strukturat ekzistuese te identifikuar per tu prishur do te largohen sipas udhezimeve te Mbikqyresit te Punimeve. Kjo do te perfshije dhe spostimin e themeleve te ndertimeve qe mund te ndeshen.

#### 3.2 Germimi per Strukturat

Germimi per strukturat duhet te jete ne perputhje me vizatimet. Anet duhen mbeshtetur ne menyre te pershtatshme gjate gjithe kohes. Nje alternative eshte qe ato mund te ngjeshen ne menyre te pershtatshme.

Germimet duhet te mbahen te pastra nga uji. Tabani i te gjithe germimeve duhet te nivelohet me kujdes.

Para fillimit të çdo gërmimi, Kontraktori duhet të marrë lejet e gërmimit dhe skarifikimit të rrugëve ashtu siç kërkohet për fillimin e punimeve nga autoritetet përkatëse si Bashkia, autoriteti rrugor, ofruesit e shërbimeve dhe policia e trafikut. Kontraktori duhet të ndërlidhet me autoritetet përkatëse



për të përcaktuar numrin e lejeve të kërkuara dhe të siguroje që ato të merren në përputhje me grafikun e punimeve.

Kontraktori duhet të aplikojë për një leje të tillë, duke njoftuar me shkrim Supervizorin dhe autoritetet përkatëse për qëllimet e tij për të gërmuar në kohë të mjaftueshme për të bërë të mundur që procedurat e nevojshme dhe miratimi të ekzekutohen. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës të lejeve nga ndërmarrjet publike/ndërmarrjet e shërbimeve publike, autoritetet komunale dhe/ose policia e trafikut.

Ai duhet të lidhet me autoritetet përkatëse në lidhje me programimin dhe ekzekutimin e Punimeve.

Punëdhënësi nuk është përgjegjës për ndëshkimet e vendosura nga autoritetet përkatëse për vonesat në afatet e parashikuara në autorizimet e gërmimeve.

Aktivitetet e gërmimeve duhet të konsistojnë në gërmime, heqje të materialit, pavarësisht nga materiali i hasur për të gjitha pjesët e punimeve. Metoda e gërmimit të Kontraktorit duhet të miratohet nga Supervizori.

### 3.3 Shtrirja e Gërmimeve

Kanalet dhe gërmimet për rrjetet nëntokësore të tubave dhe pusëve duhet të gërmohen në trasetë dhe nivelet e paraqitura në Vizatime ose siç udhëzohet nga Supervizori.

Gërmimet për kanalet nuk duhet të fillojnë derisa të gjitha materialet e nevojshme të tubacioneve të jenë në vendndërtim.

Kur sipërfaqet rrugore, trotualet dhe kynetat duhet të prishen, Kontraktori së pari duhet të copetojë sipërfaqet etj. në vija të rregullta dhe të drejta dhe duhet të heqë materialin sipërfaqësor me pelqimin e Supervizorit.

Në rast se kanalet për tubacionet gërmohen janë me seksion të ndryshuar apo të pjerret, ajo pjesë e kanalit, e cila shtrihet nga formacioni i poshtëm deri në një pikë 300 mm mbi kurorën e tubit, kur vendoset në pozicionin e saktë, duhet të ketë faqet vertikale të te njejtë seksion në dimensionet e paraqitura në Vizatime, nëse nuk miratohet ndryshe nga Supervizori.

Nuk duhet të behet asnjë gërmim në seksione të pjerreta në rrugë, rrugë për kembësore ose 10 m nga ndonjë ndërtesë ekzistuese, e propozuar apo strukturë tjetër.

Kanalet e tubave duhet të gërmohen në seksionet terthore tipike, në përputhje me Vizatimet. Kontraktori duhet të sigurojë që në çdo pikë gjerësia e kanalit të jetë e mjaftueshme për të lejuar që tubat të vendosen, ngjiten, shtrihen, testohen dhe mbushja të hidhet rreth tubit dhe ngjeshet me pelqimin e Supervizorit.

Gërmimet për kanale nuk duhet të jenë vetëm të madhësisë së mjaftueshme për të akomoduar tubat dhe materialin e shtratit, por gjithashtu të lejojnë kontraventimin e kanaleve.

Pjesa e poshtme e kanalit duhet të jetë, në çdo vend, në kuoten e duhur dhe gjerësia e dimensioneve të duhura, për të lejuar shtratin prej zhavorri, rëre dhe/ose betoni, ose mbushjen rreth tubit siç tregohet në Vizatime. Nëse ndonjë pjesë e kanalit gerموه gabimisht më e thellë se sa kërkohet, Kontraktori duhet të mbushë kanalën me material të përshtatshëm ose Beton të Klasit C15, për të përmbushur kuotat e kërkuara, me shpenzimet e tij.

Kur kërkohet saldimi ose ngjitja e tubave dhe/ose aksesorëve në kanale, kanali duhet të zgjerohet dhe/ose thellohet për të formuar gropa manovrimi.

Formacioni duhet të gërmohet si të jete i nevojshëm për nyjet, të cilat duhet të gërmohen deri në atë thellësi sa të mos prekën pjesën e poshtme të gropes.

Ky zgjerim duhet të lejojë lehtësisht ekzekutimin e duhur të të gjitha saldimeve, ngjitjeve dhe fiksimeve në të gjitha fazat e tyre, të gjitha riparimet e nevojshme në tub, si dhe inspektimin terësor të të gjitha këtyre aktivitetëve. Formacionet e kanaleve duhet të jenë në tokë të pa prekur.

### **3.4 Germimi i Materialit të Dobet**

Nëse ka ndonjë material të dobët në themelet e strukturave ose kanaleve të tubacionit, Kontraktori duhet ta heqë atë dhe do largojë atë me pelqimin e Supervizorit. Nëse nuk specifikohet ose urdhërohet ndryshe nga Supervizori, Kontraktori duhet të plotësojë boshllëqet në themelet e formuara me materialin mbushës të aprovuar.

Nëse Kontraktori has në ndonjë material që sipas mendimit të tij mund të jetë i dobët, ai duhet menjëherë të informojë Supervizorin i cili më pas duhet ta udhëzojë Kontraktorin me shkrim nëse materiali në fjalë duhet të trajtohet si i papershtatshëm.

Nëse materiali konfirmohet si i dobët, Kontraktori duhet ta heqë atë dhe do largojë atë me pelqimin e Supervizorit.

Keto punime duhet të paguhen nga Punëdhënësi me kusht që papërshtatshmëria e formacionit nuk rezultoi për shkak të metodës së punimeve të Kontraktorit. Kostoja e trajtimit të këtij materialit duhet të përballohet nga Kontraktori nëse, sipas mendimit të Supervizorit, është për shkak të mosrespektimit të Kërkesave të Punëdhënësit nga Kontraktori, duke përfshirë mbajtjen e gërmimeve pa prani të ujit.

---

---

### **3.5 Shkarkimi i Materialit te tepert nga germimi**

Materiali i përshtatshëm i tepert dhe i gjithë materiali i papërshtatshëm duhet, nëse Supervizori nuk lejon ndryshe, të hiqet nga vendndertimi me shpenzimet e Kontraktorit me pelqimin e Supervizorit dhe volumet e aprovuara nga Supervizori. Vendet e depozitimit koordinohen me qeveritë vendore dhe duhet të lidhet një kontratë e veçantë.

### **3.6 Mbushja e Tubacionit**

Asnjë mbushje nuk duhet të kryhet derisa të gjitha mbeturinat dhe materialet e tjera të jenë hequr nga gërmimet. Kanalet duhet të mbushen pa vonesë, por jo përpara se tubat dhe strukturat të inspektohen dhe miratohen nga Supervizori.

Supervizorit duhet t'i jepet njoftim 24 orë më parë me qëllimin për të mbushur, në të cilën kohë ai duhet të kryejë inspektimin e tij.

### **3.7 Shiriti Paralajmerues**

Jo më thellë se 60 cm nën nivelin e sipërfaqes përfundimtare, duhet të vendoset një shirit paralajmërues plastik me tregues të vendndodhjes sipas standardit përkatës në gjatësinë totale për të mbrojtur tubin dhe të mundësojë një zbulim të mëvonshëm. Ngjyra dhe mbishkrimi duhet të jenë sipas qëllimit të synuar. Shiriti paralajmërues duhet të jetë me ngjyrë të shkëlqyeshme dhe të paktën 40 mm i gjerë.

### **3.8 Mbushja Përfundimtare e Kanaleve dhe Tubave**

Mbushja e kanaleve duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur pasi tubat të jenë vendosur në mënyrë të kënaqshme dhe të aprovohen nga Supervizori. Kanali duhet të mbushet me material të importuar ose të përzgjedhur nga germimi.

Ngjeshja duhet të kryhet me pajisje të duhura. Megjithatë, deri në 0.90 m mbi tub, ngjeshja duhet të kryhet me pajisje të lehta.

Makineritë e përdorura për ndërtimin e rrugëve duhet të përdoren vetëm nëse është konstatuar se nuk ka efekt negativ në tubin poshtë.

Materiali përfundimtar mbushes duhet lagur dhe sistemuar në shtresa jo më të thella se 30 cm para ngjeshjes. Cdo shtresë ngjeshet plotësisht nga një pajisje mekanike me vibrim e aprovuar, para se të vendoset secila shtresë pasuese.

Përhapja dhe ngjeshja duhet të kryhet në mënyrë të barabartë me një metodë të aprovuar nga Supervizori.

Një shkallë ngjeshjeje  $DPr \geq 97\%$  është e nevojshme për mbushjen e rrugëve. Me përjashtim të rrugëve dhe sipërfaqeve të tjera të shtruara, ngjeshja e kanaleve duhet të arrije deri në nivelin natyror të tokës natyrore me material të ngjeshur në shkallë të paktën 95%. Kontraktori duhet të kryejë teste (d.m.th. testin e ngarkesës me pllakë) për të verifikuar shkallën e specifikuar të ngjeshjes.

Kur dherat e sipërm janë në sipërfaqen e trasesë se tubit, pjesa e sipërme e mbushjes duhet të jetë e trashësisë së përshkruar, ose me të njëjtën trashësi dhe cilësi të shtresës së sipërme si toka përreth.

Në rast se materiali i gërmuar nuk mund të përdoret, Kontraktori duhet ta zëvendësojë atë me material të aprovuar nga zonat e marrjes se materialeve në afërsi të vendndertimit. Kontraktori duhet të identifikojë zonat e përshtatshme në afërsi të Vendndertimit.

Materiali i gërmuar i kthyer duhet të vendoset me përmbajtje optimale të lagështisë gjatë gjithë kohës gjatë mbushjes.

### 3.9 Hapja e Pusit

Për të realizuar shpimin në thellësin e kërkuar rëndësi ka zgjedhja e makinerisë së përshtatshme për realizimin e detyrës.

Në rastin tone ku në bazë të prerjes litologjike takojnë shtresa suargjila, zhavorre, ranorë e argjila me përbërje dhe fortësi të ndryshme duhet që të zgjidhen këto makineri.

- a) Autosondë me Goditje
- b) Skrep për hapjen e gropave të lëngut larës.
- c) Kamion për transport të bazës material të nevojshme.
- d) Kamion byliko për transport tubo rrethimi dhe tubo shpimi.
- e) Gjenerator (15 – 20 KË) për prodhimin e rrymës elektrike.
- f) Saldatriçe për kryrjen e punimeve të ndryshme të ngjitjes.
- g) Mjet për transport punëtorësh për lëvizjet e tyre.
- h) Kamioni bot për transportin e ujit që është baza e lëngut larës.

Në mbështetje të diametrit dhe thellësisë së pusit dhe konstruksionit të tij, përcaktohet baza material e domosdoshme për realizimin e shpimit. Kështu për shpimet me rrotullim baza material është:

- a) Naftë e llogaritur në bazë të fuqisë motorike të instaluar.
- b) Vaj.
- c) Tubo dhe filtra me diameter të përcaktuar në projekt.
- d) Dalta sipas diametrit të pusit dhe formacioneve që do të shpohen.
- e) Materiale konsumi (si litar, çelik, litar liri, graso etj).
- f) Në bazë të makinerive të kërkuara, bazë material dhe fuqisë punëtore bëhet llogaritja e shpenzimeve. Llogaritja e shpenzimeve në shpimin me rrotullim bëhet duke llogaritur

kohën aktive dhe kohën ndihmëse që duhet për realizimin e detyrës që përcakton projektin.

- g) Kaha aktive për shpimin e puseve hidrogeologjike është në përpjestim të drejtë me metrazhin që do të shpohet dhe në përpjestim të zhdrejtë me shpejtësinë mekanike që ka dalta në përputhje me formacionet që kalon.
- h) Në përgjithësi dalta prodhohet në regjime të caktuara shpimi, ku përbërësit kryesor janë pesha mbi daltë, numri i rrotullimeve dhe presioni i pompës të cilës për vet karakteristikat e makinerive, nuk kënaqin kërkesën e prodhuesit. Në këto kushte konsumimi i daltave nuk përputhet me të dhënat e pashaportës së tyre.

### 3.10 Testet e Ujerave Nëntokësore

Gjatë punimeve, Supervizori duhet të kërkojë që të merren mostra të ujerave nëntokësore për testime për të konstatuar praninë e substancave të dëmshme.

Testet kryhen në fillim të punimeve të zbatimit në një laborator përpara fillimit të punimeve.

### 3.11 Tubat dhe Pjesët prej Gize

Tubat e gizes për sistemin e furnizimit me ujë do të kenë karakteristikat dhe kërkesat sipas EN 545/10 dhe specifikimeve bashkangjitur projektit.

- Tuba gize për ujë të pijshëm në përputhje me standardet EN 545: 2010, ISO 2531: 2009, tuba të klasës C40, C30 dhe C25;
- nga DN80 deri DN600: gjatësi tubi 6 metra;
- nga DN700 deri DN1000: gjatësi tubi 7 metra;
- mbi DN1100: gjatësi tubi 8 metra.

Tubat zakonisht do të ketë në skaj një folë për lidhje elastike, me anë të një unazë gome në përputhje me UNI 9163/87, me unazë elastomeri sipas standardit EN 681-1. Nga ana tjetër, nëse autorizohet, mund të përdoret lidhje elastik e tipit Tyton, sipas DIN 28603.

- **Sistem ankerimi për DN1100 ose më të madh, tubacionet duhet të jenë të pajisur me një sistem fiksimit me anë të një tegel saldimit. Funkcionet hidraulike dhe të fiksimit duhet të jenë të ndara.**

Lidhja duhet të lejojë zhvendosjen këndore dhe devijimet gjatësore të tubit pa kompromentuar lidhjen.

Tubat, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga kërkesat e projektimit, duhet të jenë të veshura nga brenda me llaç çimentoje sipas EN 545/10 (shënuar me CE në bazë të Rregullores Evropiane 305/2011) dhe ISO 4179, dhe nga jashtë me një shtresë aliazhi zinku dhe alumini ose Zn-Al aliaz bakri Cu, monofazor (Zn 80-90%; 10-20% Al), 400 gr/m<sup>2</sup>, aplikuar si veshje dhe veshje reshire sintetike në përputhje me trashësi të zinkut jo më pak se 70 µm (UNI ISO 8179).

- **Veshje e jashtme, për të gjitha diametrat deri në DN1200: 400gr aliazh zink-alumini (veshje Natural) dhe një shtresë bazë epoksi blu ose bojë akrilike.**

Llaçi duhet të behet me çimento furre, në përputhje me Standardin EN 197-1 dhe Direktivën 98/83/EC; inertet duhet të jenë në përputhje me standardin e harmonizuar 13139. Këto materiale janë të detyrueshme me shenimin CE dhe duhet të përzihen me ujë të pijshëm. Çdo furnizim në impiantin e prodhimit të tubave duhet të shoqërohet me Deklaratën e performancës së prodhuesit të çimentos/inerteve përgatitur në përputhje me Rregulloren Evropiane nr. 305/2011.

Për dherat agresive (rezistiviteti <math><1.500 \Omega \text{ cm}</math>) veshja e jashtme duhet të bëhet ose me një shtresë zinku të pastër prej 200 gr/m<sup>2</sup> mbuluar me një shtresë polietileni, aplikuar në përputhje me EN 14628, ose poliuretani, aplikuar në përputhje me EN 15189.

Pajisjet e gizes për tubat e ujësjellësit duhet të prodhohen në fabrika të certifikuar me ISO 9001 dhe duhet të jenë në përputhje me EN 545/10, e ndryshuar; pajisjet duhet të kane skaje të përshtatshme për llojin e lidhjes të kërkuar nga specifikimeve të projektimit. Përveç nëse kërkohet ndryshe, lidhja do të jetë e llojit mekanike me bulona elastike në përputhje me UNI 9164/94.

Fllanxhat duhet të ketë dimensione dhe shpime sipas EN 10092-2 dhe EN 545/10 dhe EN 545/10.

Të gjitha pajisjet, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga kërkesat e projektimit, do të jenë të veshura nga brenda dhe jashtë, si më poshtë:

- bojë epoksi me një trashësi jo më pak se 70 pm, sipas EN 545/10 dhe ndryshimet e mëvonshme dhe EN 14901;
- për tokat agresive, mund të përdoren veshje me një trashësi prej jo më pak se 250 pM ose veshje poliuretani në përputhje me EN 15189, ose, pas autorizimit, mund të sigurohen manikota në PE në veshjen e jashtme mbrojtëse;
- tapat EPDM përveç standardit duhet të kërkohet një certifikim nga një organ certifikues i autorizuar që materiali është i përshtatshëm ekskluzivisht për ujë të pijshëm, sipas Direktivës Evropiane 98/83/EC;
- sistem ankerimi për DN1100 ose më të madh, tubacionet duhet të jenë të pajisur me një sistem fiksimit me anë të një tegel saldimi. (Funkcionet hidraulike dhe të fiksimit duhet të jenë të ndara).

Veshja nuk duhet të përmbajë ndonjë material të tretshëm në ujë dhe asnjë produkt që mund të japë shije ose aromë në ujë, si dhe nuk duhet të përmbajë elemente toksike:

- veshja e brendshme llaçi, e certifikuar nga enti autorizues në përputhje me EN 197-1;
- komponentët e rrjetit e tubacioneve (pajisjet dhe tuba) duhet të vijnë nga i njëjti prodhuesi.

Për të gjitha muret e brendshme dhe për unazat izoluese, furnizuesi i materialeve duhet të ketë një certifikatë të analizave kimike, krahasuar me mostrat e marra; në veçanti, analiza duhet gjithashtu të

kryhet në mostrat e vendosura në kontakt me ujin e rrjetit të shpërndarjes (ujë i klorinuar me një përqendrim prej të paktën 1 ppm).

Lidhjet që nuk lejojnë zhvendosjen gjatësore mund të përdoren për të zëvendësuar apo plotësuar blloqet e ankerave, dhe duhet të jenë në përputhje me EN 545/10 dhe LSI

Të gjitha materialet e gizes duhet të kenë të paktën shenjat e mëposhtme:

- Emri ose marka e prodhuesit;
- viti i prodhimit;
- shenimi i te dhenave të gizes;
- diametri nominal;
- për fllanxhat, klasifikimi sipas PN;
- referenca për standardin EN 545/10 dhe ndryshimet e mëvonshme;
- shenjat e konformitetit të lëshuar nga një organ i palës së tretë.

### 3.12 Certifikatat

Kontraktori duhet të sigurojë:

- certifikim konformiteti i Cilesise lëshuar nga organizem i akredituar për tubacione për furnizim me ujë të pijshëm (i akredituar sipas DIN EN ISO/IEC 17065: 2013- 01);
- prova të testeve lëshuar nga laborator i akredituar në përputhje me ISO/IEC 17025: 2005 që provon se produktet e ofertuar janë të te pershtatshme dhe të sigurta në përdorimin e tyre për ujë të pijshëm;
- një Certifikatë nga trupi certifikues i autorizuar që uji i përdorur për llaçin e veshjes është uje i pijshëm, në përputhje me Direktivën Evropiane 98/83/CE dhe se çimentoja e përdorur në përputhje me EN 197-1;
- një Certifikatë e lëshuar nga prodhuesi i aplikimit të aliazhit të lart-specifikuar me qëllim mborjtjen e jashtme të tubave në përputhje me EN 545: 2010, duke konfirmuar cilësinë e veshjes së jashtme;
- një Certifikatë e lëshuar nga organizmi certifikues, i autorizuar për certifikimin e produktit në përputhje me EN545: 2010 (akredituar nga enti akreditues që është një anëtar i EA - Shoqata Evropiane e Akreditimit), duke konfirmuar këtë prodhues në prodhimin e shtreses së aliazhit zink-alumin (85% - 15%) 400g/m<sup>2</sup> trashësi;
- një Certifikatë lëshuar nga një organ certifikues, i autorizuar për certifikimin e produktit në përputhje me EN545: 2010 (akredituar nga enti akreditues që është një anëtar i EA - Shoqata Evropiane e Akreditimit), duke konfirmuar cilësinë e kërkuar të tapave në përputhje të plotë me EN 681 -1, ISO 4633;

- Certifikate lëshuar nga një organ certifikues që materiali i përdorur për prodhimin e tapave dhe për përdorim ekskluziv për ujë të pijshëm, në përputhje me Direktivën Evropiane 98/83 / EC;
- Deklarata nga prodhuesi që konfirmon se produktet e ofruara janë plotësisht në përputhje me kushtet teknike të kërkuara.

### 3.13 Rregulloret

Tubat e gizes për sistemin e furnizimit me ujë do të kenë karakteristika dhe kërkesa sipas EN 10224 si dhe kërkesat e ndonjë specifikim bashkangjitur projektit.

Lidhjet e tubave të gizes duhet të perputhen me kërkesat e standardit EN 10224 lartpërmendur.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në vizatimet e projektimit, skajet e tubave të gizes duhet të jenë të predispozuar për lidhje me fole ose me fllanxhs.

Pajisjet dhe fllanxhat duhet të jene në përputhje me ISO 2084 dhe të aplikohen në terren sipas vizatimeve dhe të gjitha lidhjet duhet të kryhen me pajisje hidraulike.

Veshjet e brendshme dhe të jashtme duhet të korrespondojnë me kërkesat e Shtojcës D për standardet e mësipërme EN 10224.

Veshja e jashtme duhet të përmbushë kërkesat e EN 545-2010; ISO 2531-2009.

Shtresa e jashtme: Shtrese ZINALIUM® zink-alumin (85/15, 400g / m<sup>2</sup>) + bojë blu epoksi ose ekuivalente (ACS, KTW, WRAS).

Veshja e brendshme me cemento të centrifuguar.

Kompania që furnizon materialet e destinuar për kontakt me ujë të pijshëm (unazat izoluese, veshjet e brendshme të tubave, etj.) duhet ti dorëzojë kontraktorit deklaratën e konformitetit.

### 3.14 Shenjat në tuba dhe pajisje

Tuba dhe pajisje duhet të kenë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- Emri ose marka e prodhuesit;
- Viti i prodhimit;
- shenimi i te dhenave të gizes;
- diametri nominal;
- për fllanxhat, klasifikimi sipas PN;
- referenca të UNI EN 545;
- klasa e presionit.



Pese te dhenat e para te listuara më sipër duhet të kryhen direkt në fazën e shkrirjes ose formimit te tubave ne te nxehte, ose ne te ftohtë; dy të dhënat e tjera mund të aplikohen gjithashtu me shtresë sipërfaqësore apo paketimin fiks.

Shënimi ne tub duhet të fillojë jo më shumë se 300 mm nga një skaj.

Çdo dorëzim duhet të shoqërohet me një kopje të certifikatave.

e konformitetit.

## 3.15 Punime rrethimi

Ndertim rrethimi me rrjetë teli përfshirë: gërmimin, plintin e betonit C25/30, Shufrat e ankorimit Ø10 mm, Profilin T të zinkuar (50x50x5) mm, Shufrat e çelikut Ø25 mm dhe rrjeten e telit të zinkuar.

## 3.16 Portat

Portat duhet të jene te cilësise më të mirë të disponueshme me tuba çeliku për kornizë, dhe përpara se të behet porosia, Kontraktori duhet të paraqesë për miratimin e Supervizorit vizatimet e portave që ai propozon të furnizojë. Portat duhet të jenë të kompletuara me doreza, stopues dhe brave me tre çelësa.

Nëse nuk specifikohet ndryshe, portat duhet të jenë varur ne dy ane, te kombinuaramë një derë, material: çelik i galvanizuar, veshja: me pluhur poliester.

## 3.17 Fidane Peme Dekorative dhe Sistemimi i Vendndertimit

### 3.17.1 Dorezimet

Para fillimit të çdo pune sistemimi, Kontraktori i paraqet Supervizorit për miratim propozimet e tij të hollësishme, përfshirë speciet e propozuara të barit, pemëve dhe shkurreve.

### 3.17.2 Prerja e pemëve

Kur udhezohet nga Supervizori, pemët dhe shkurret ekzistuese duhet të priten dhe të gjitha rrënjët dhe degët duhet të grumbullohen. I gjithë materiali bimor që trajtohet në këtë mënyrë duhet të copëtohet dhe groposet në tokë.

### 3.17.3 Zëvendësimi i pemëve të dëmtuara

Nëse ndonjë pemë ose shkurre dëmtohet si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit, duhet të zëvendësohet nga Kontraktori me (dy) pemë të rritura ose (tre) shkurre të te njëjtit lloj.

Error! Unknown document property name.

---

Error! Unknown document property name.

---

Rish. Error! Unknown document property name.

---

---

---

### **3.17.1 Koha e mbjelljes**

Në programimin e punimeve të mbjelljes, Kontraktori duhet të marrë parasysh kohet e pranuar për mbjellje. Nëse koha e përfundimit të jetë e tillë që punimet e sistemimit duhet të kryheshin në një kohë kur mbjellja është e papranueshme, atëherë Kontraktori mund të paraqesë pranë Supervizorit për leje për shtyrjen e mbjelljes deri në një kohë më të përshtatshme të vitit.

## 4 Matesi i Ujit

Matësat e ujit furnizuar dhe instaluar sipas kësaj kontrate duhet të jenë në përputhje me të gjitha standardet përkatëse, veçanërisht me standardet e përgjithshme në vijim:

Standardet e përgjithshme vijuese duhet të zbatohen:

- ISO 4064-1: Matja e prurjes së ujit në percjelles të mbyllur - Matës për ujë të ftohtë të pijshëm - Specifikimet,
- ISO 4064-2: Matja e prurjes së ujit në percjelles të mbyllur - Matës për ujë të ftohtë të pijshëm - Kërkesat e instalimit,
- ISO 4064-3: Matja e prurjes së ujit në percjelles të mbyllur - Matës për ujë të ftohtë të pijshëm - Metodat dhe pajisjet e testimit.

Matësit e ujit duhet të jenë në përputhje me EN 14154, OIML R49.

Prodhuesi duhet të ketë certifikata në përputhje me ISO 9001 dhe ISO 14001.

Të gjithë matësit e ujit duhet të kenë aprovime MID dhe Deklaratë të Pajtushmërisë.

Kontraktori duhet të paraqesë kopjet e këtyre dokumenteve.

### 4.1 MATES Uji Woltman

Matësi i ujit Woltman duhet të përgatitet për leximin automatik.

Matësi kryesor: mekanik (Woltman), me regjistër të thatë, i lexueshëm përherë, plotësisht i mbrojtur nga përmytja, lagështia dhe kondensimi, dinamika metrologjike (Q3/Q1) R 80 (për t'u certifikuar).

Matësit kryesorë dhe sekondarë duhet të jenë me kapak mbrojtës.

Të gjithë matësit e ujit duhet të kenë aprovime MID dhe Deklaratë të pajtushmërisë.

Matësit duhet të jenë për lidhje në linje, hyrje dhe dalje që kanë një aks të përbashkët.

Matësit e ujit të përbërë duhet të kenë lidhje fundore me fllanxha; shpimi në përputhje me PN 16.

Të gjithë matësit e ujit duhet të furnizohen me bulona çeliku të galvanizuar, dado dhe rondele, dhe një sërë izolues me fllanxha të aprovuara për ujë të pijshëm.

Kërkesa teknike:

-Pozicioni i instalimit: horizontal,

-Klasa kundër mbrojtjes: IP 68 (mekanizëm rezistent ndaj lagështirës dhe përmytjes),

Error! Unknown document property name.

---

**Error! Unknown document property name.**

---

Rish. **Error! Unknown document property name.**

---

- 
- E gjithë njësia kryesore me kuti dhe sensorë të jetë 350° rrotullues,
  - Kutia me veshje të paktën epoksi GG25, mbrojtur nga korrozioni dhe demtimi,
  - I kaibrueshem, mekanizmat e matjes te zevendesueshem per te dy matesit e ujit,
  - Transmetues impulsiv induktiv/elektronik,
  - Xhami me mundësi për instalim të drejtpërdrejtë, pa tel të njësisë së leximit (preferohet pa bulona)

Error! Unknown document property name.

Error! Unknown document property name.

Rish. Error! Unknown document property name.

**Tabela 4-1: Te dhenat e matesve te ujit**

Diametri nominal DN (mm)	50	80	100
Gjatësia mesatare (mm)	270	300	360
Prurja nominale Qn (m <sup>3</sup> /orë)	15	40	60
Klasa e temperaturës EN 14154	T 50		
Presioni nominal	PN16		
Gama e rishikimit	0,5 l në 999,999 m <sup>3</sup>		
Klasa e mbrojtjes	IP 68		
Matës kryesor i ujit:			
Sensori i pulsit	Mundësia për 2 sensorë		
Vlera e pulsit	0,1 deri në 1 m <sup>3</sup> /puls		
Matës sekondar uji:			
Sensori i pulsit	Sensori induktiv/elektronik		
Vlera e pulsit	1 l/puls		

---

---

## 5 Pompa Zhytесе

Pompe zhytесе per pus, e pershatshme per uje te paster dhe te pijshem mund te instalohet vertikalisht ose horizontalisht. Te gjithе elementet metalik ne kontakt me ujin prej materiali Celik Inox, EN 1.4301 (AISI 304), qe garanton rezistence te larte ndaj korrozionit. Pompe e Certifikuar per Uje te Pijshem sipas ACS, DM174.

Kapaciteti I Pompes (kurba e punes duhet te mbuloje pikat e punes):

1. Q = 140 m<sup>3</sup>/h ; H=250 m ;

2. Q = 180 m<sup>3</sup>/h ; H=200 m;

3. Q = 260 m<sup>3</sup>/h ; H=150 m ;

Fuqia elektrike P<sub>2</sub>=147 kW ;

Eficenca e Pompes > 80% ; Eficenca Pompe + Motor > 70% ;

Menyra e Startimit : Direct On Line ;

Tensioni 3 x 380-400-415 V ;

Rryma 315-315-320 A ;

Shpejtesia e rrotullimeve 2920-2920-2930 rpm ;

Materiali Pompes : Celik Inox sipas EN 1.4301-AISI 304 ;

Helikat: Celik Inox sipas EN 1.4301-AISI 304 ;

Motori : Gize sipas DIN W.-Nr. 0.6025 - ASTM 35-40 ;

Diametri I Pompes : 10" inch ;

Dimensioni I lidhjes (me fileto) : RP 6" ;

Klasi I hermetizimit (IEC 34-5) : IP68 ;

Toleranca e Kurbes se Punes : ISO9906:2012 3B ;

Valvol mos-kthimi e inkorporuar ne trupin e pompes per mbrojtjen ndaj grushtit hidraulik Pesha Neto : 626 kg.

Konvertitor Frekuence I Jashtem disenjuar per komandimin e shpejtesise se Pompes me PI controller te inkorporuar.

Error! Unknown document property name.

---

**Error! Unknown document property name.**

---

Rish. **Error! Unknown document property name.**

---

Fuqia : 200 kW ;

Tensioni : 3 x 380-440/441-500 V ;

Rryma : 395-361 A ;

Aprovimet: CE, CULUS, C-TICK ;

Klasa e Hermetizimit (IEC 34-5): IP21 ;

Konvertitori I Frekuences duhet te kete keto sinjale hyrese dhe dalese (inputs/ output):

RS-485 GENIbus

nje sinjal analog 0-10 V per piken e punes te vendosur nga jashte

nje sinjal analog 0/4-20 mA per sensorin

kater input dixhital per funksione te ndryshme,

per start/stop nga jashte

dy re-le sinjali (C/NO/NC) ;

Pesha Neto: 125 kg

## 6 Punimet e Betonit

### 6.1 Të përgjithshme

#### 6.1.1 Referencat

- EN 206-1: 2013: Betoni. Specifikimet, performanca, prodhimi dhe përputhshmëria.
- Jetgjatesia (vite)
- Udhezime per perdorim (veprim), vendosje ne pune, mirembajtje
- Sistemi I kontrollit te cilesise, certifikatat
- Kerkesa per transportin dhe vendosjen
- Protokolli I testeve dhe lista e testeve
- Impakti ne ambient
- Deklarimi I statusit per ricikilimin e materialeve te perdorura
- Deklarimi per mungese PCB
- Te kete markim CE

#### 9.1.2 Kerkesa te pergjithshme

##### 9.1.2.1 Specifikime Reference

Trasformatoret duhet te furnizohen dhe testohen ne perputhje me specifikimet te Komisionit Nderkombetar Elektroteknik:

- Kordinimi i izolacionit(Insulation co-ordination) SSH EN IEC 60071
- Transformatorret e fuqise(Power transformers) SSH IEC 60076
- Izolatorete kalimtare per tensione alternative mbi 1000 V (Bushings for alternating voltages above 1000 V) SSH EN 60137
- Dimensionet e tubave, prizhoniereve dhe shufrave të oksideve feromagnetike (Dimensions of tubes, pins and rods of ferromagnetic oxides IEC 220
- Testi i izolatoreve mbeshtetes per perdorim ne paisjet elektrike (Tests on hollow insulators for use in electrical equipment) IEC 60233
- Matja e shkarkimeve te pjeseshme (Partial discharge measurements) SSH EN 60270

- Specifikimet per vajin izolues minaral te pa perdorur per transformatore dhe celsa (Specification for unused mineral insulating oils for transformers and switchgear) SSH EN 60296
- Shkallet e mbrojtjes te ofruara per paisjet e mbyllura (Kodi IP) (Degrees of protection provided by enclosures (IP Code) SSH EN 60529
- Transformoret e fuqise-Pjesa 10 Percaktimi i niveleve te zhurmes ( Determination of transformer and reactor sound levels) SSH EN 60076-10
- Specifikimet per celik strukturor (Specification for structural steel) ASTM A36

Percaktimet e dhena me siper sipas publikimeve te SSH, EN ose IEC do te aplikohen me poshte. Ne rast se kerkesat e meposhtme ndryshojne nga ato te dhena ne IEC te mesiperme, ne nje fushe te vecante, transformoret duhet te plotesojne kerkesat e listuara me poshte sipas ketij artikulli. Per kete qellim skemat dhe llogaritjet sipas sistemit SI do te perdoren.

#### 9.1.2.2 Kushtet e sherbimit

Strukturat , paisjet dhe te gjithe aksesoret duhet te jene te pershtatshem per perdorim nen kushtet e meposhtme.

Tabela 9-1: Transformatorët e shpërndarjes - kushtet e shërbimit

Lartesia	Deri 1000 m mbi nivelin e detit
Lageshtia relative maksimale	80%
Temperatura maksimale e ambientit	40°C
Temperatura mesatare vjetore	15°C
Temperatura minimale	-33°C
Temperatura maksimale e ambientit per 24 orë	35°C

#### KUSHTET E ERES

Deri 40 m/sec, strukturat dhe paisjet sipas ketij specifikimi duhet te jene ne gjendje te durojne shtypje te vazhdueshme mekanike ekuivalente me eren 150 km/h. (1000 N/m<sup>2</sup>).

#### KUSHTET SIZMIKE

Strukturat dhe paisjet perdorur sipas specifikimeve duhet te jene ne gjendje te durojne lekundje sizmike horizontale se paku 2.5 ms<sup>-2</sup>. Per qellime projektimi 80 % e vleres se mesiperme duhet te konsiderohet per lekundjet vertikale sizmike.

#### SHKALLA E KONTAMINIMIT

Niveli i ndotjes konsiderohet si ndotje e pakapshme. Distanca e shkarkimit duhet te jete 25 mm/kV.

#### 9.1.2.3 Sistemi i tokezimit

TM 35, 20, 10 dhe sistemi 6 kV : Me neuter te izoluar. Sistemi TU 0.4 kV : Neuter te tokezuar direct.

#### 9.1.2.4 Niveli i izolimit dhe lidhjes se shkurter

#### NIVELI I IZOLIMIT

---

---

Paisjet duhet te plotesojne nivelin e izolimit permendur me poshte. Per percaktime dhe perfundime ne parametrat e nivelit te izolimit, do te perdoren shkurtimet e meposhtme.

- AC Tensioni qe duron ne frekuence industriale, 60 sekonda
- Li Tensioni impulsive qe duron, 1,2 /  $\mu$ 50 sec
- SI Tensioni impulsive qe duron ne kycje, 250/3500  $\mu$  sec.

#### **NIVELI I IZOLIMIT RRJETI 35 KV**

- 1) Tensioni me i larte i sistemit 38.5 kV rms
- 2) AC 70 kV rms
- 3 )Li 170 kVrms
- 4) Neutri i transformatorit AC Plotesisht e izoluar.

#### **NIVELI I IZOLIMIT RRJETI 20 KV**

- 1) Tensioni me i larte i sistemit 24 kV rms
- 2) AC 50 kV rms
- 3) Li 125 kVrms
- 4) Neutri i transformatorit AC Plotesisht e izoluar.

#### **NIVELI I IZOLIMIT RRJETI 10 KV**

- 1) Tensioni me i larte i sistemit 12 kV rms
- 2) AC 28 kV rms
- 3) Li 75 kVrms
- 4) Neutri i transformatorit AC Plotesisht e izoluar.

#### **NIVELI I IZOLIMIT RRJETI 6 KV**

- 1)Tensioni me i larte i sistemit 7.2 kV rms
- 2) AC 20 kV rms
- 3) Li 60 kVrms
- 4) Neutri i transformatorit AC Plotesisht e izoluar.

#### 9.1.2.5 Niveli i izolimit dhe hapësirat

Paisja duhet të jetë e përshtatshme për përdorim të vazhdueshëm në një sistem tre fazë 50 Hz. Hapësira (distance) e punës siguroar në instalimet e jashtme midis paisjes së izoluar dhe pjesë me të afërt metalike nuk duhet të jetë më pak se hapësira e specifikuar dhe nëse nuk është e specifikuar duhet të aplikohet standarti IEC për hapësirat. Distanca e shkarkimit në izolatore dhe pjastra nuk duhet të jetë më e vogël se 25 mm/kV në sistemin me tension më të lartë për paisjet e jashtme.

#### 9.1.2.6 Niveli i lidhjes së shkurter

Paisja duhet të ketë nivel të lidhjes së shkurter si më poshtë.

##### **Rrjeti 35 kV, niveli i lidhjes së shkurter**

- 25 kA rms, 3 sekonda

- 50 kA pik.

##### **Rrjeti 20 kV, niveli i lidhjes së shkurter**

- 25 kA rms, 3 sekonda

- 40 kA pik.

##### **Rrjeti 10 kV, niveli i lidhjes së shkurter**

- 25 kA rms, 1 sekonde

- 40 kA pik.

##### **Rrjeti 6 kV, niveli i lidhjes së shkurter**

- 25 kA rms, 1 sekonde

- 40 kA pik.

#### 9.1.2.7 Përshkrim, kërkesa dhe të dhëna për transformatorët

Transformatori i shpërndarjes do të jetë transformator i mbushur me vaj I tipit të mbyllur hermetikisht ONAN. Transformatorët do të ketë vlerë nominale të tensionit prej  $\pm 0.4$  kV. Regullatori i tensionit i cili vendoset në anën TM, do të jetë plus-minus 5 % me 2.5 % në çdo shkallë.

Grupi I lidhjes do të jetë sipas aneksit 1.

Daljet TM dhe TU të transformatorit do të jenë për kablllo.

Temperatura maksimale e lejuar do të jetë:

- Vaji 600 C (pjesa e sipërme)
- Pështjellat 650 C (shtresa më e nxehtë)

Transformatori i fuqisë do të jetë i ndërtuar në atë mënyrë që të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

- Të ketë cilësi për t'i rezistuar çdo tronditjeje gjatë transportit dhe instalimit

- Të sigurojë shpërndarje efikase të nxehtësisë
- Të jetë i papershkueshen nga uji dhe vaji i nxehtë
- Të kete zhurma dhe dridhje deri në një nivel te lejueshem.

Jetëgjatësia teknike duhet të jetë 35 vjet.

#### **Nukli I transformatorit**

Konstruksioni i qarkut magnetic duhet te jete i tille qe te shmange zhvillimin e shkarkimeve statike te lidhjes se shkurter ne konturin e brendshem ose ne strukturen fiksuese te tokezuar dhe prodhimin e komponentes se fluksit pingul me fleten e celikut te petezuar. Çdo fletë e petëzuar do të izolohet me material te qëndrueshëm në kushtet e punës. Qarku magnetic do te tokezohet nepermjet nje lidhje testuese te heqeshme me konstruksionin metalik, e cila vendoset ne nje pozicion te favorshem. Nukli i transformatorit do të prodhohet prej çeliku të cilësisë së lartë me kristale te orientuara. Nukli duhet te jete i perbere nga flete celiku te petezuara dhe çdo fletë e petëzuar do të jetë e izoluar me llak të përshtatshëm për të shmangur humbjet nga rrymat fuko.

Nukli do te mbeshtetet ne bazament nepermjet fiksueseve te izoluar dhe do te tokezohet nepermjet nje lidhje te heqeshme. Nukli (fletet e llamarines)do të jetë i mbrojtur ndaj gërryerjes duke u lyer me nje shtrese llaku me trashësi e pakta 1mm.

#### **Peshtjellat**

Transformtorët do të kene peshtjella bakri elektrolit me përcjellshmëri të lartë.

Materiali i izolimit do të jetë e Klases A (IEC 76-2).

Izolimi i peshtjellave dhe lidhjet do te jete i lire nga kompozimi I izolacionit per te zbutur tkurjen ose keputjen gjete shfrytezimit. Peshtjellat do të jenë prej bakri elektrolitik. Në mënyrë që të arrihet qëndrueshmeria ndaj lidhjeve te shkurtra nga ana e tensionit te ulet , peshtjella e tensionit te ulet do te ndertohet me shirita bakri ne vend te percjellesave. Transformatori do të ketë izolim të Klases A ose izolim më të mirë. Peshtjellat mund të izolohen me letër izoluese ose llak në përputhje me standardet e Prodhuësit. Ndertimi I peshtjellave do të jetë i tillë që të arrihet një shpërndarje e njetrajteshme e tensioneve impulsiv dhe tensioneve te shkarkimeve, duke shmangur pikat e dobëta në izolim.

#### **Kazani**

Kazani i transformatorit do të prodhohet prej materiali me trashësi dhe fortësi të tillë që të rezistojë pa u dëmtuar apo pa u mbinxehur në kushtet e punës ose gjatë lidhjes se shkurtër. Transformatori do të jetë pa zgjerues vaji .Për kazanin dhe pjese të tjera, preferohet të përdoren konstruksione të salduara. Sistemi ftohës i transformatorit do të jetë me fletë llamarine ne pjesët anësore te depozitës.

Transformatori do të pajiset me rrota qe lëvizin ne të dyja drejtimet për instalimin në objekt.

#### **Rregullatori i tensionit**

Rregullatori I tensionit do të sigurohet nëpërmjet një çelësi dhe do të vendoset në një vend të përshtatshëm (mbi kapak) për tu manovruar lehtësisht. Rregullatori I tensionit do te pajiset me një çelës rregullues me doreze te jashtme rrotulluese qe siguron bllokimin e rregulluesit ne pozicionin e zgjedhur. Mekanizmi duhet të jete nga jashtë transformatorit per manovrimin e tij. Pozicionet e rregullatorit te tensionit duhen shënuar qartë dhe të mos fshihen me kalimin e kohes. Pozicionet që korrespondojnë me vleren e rregullimit te rregullatorit do të stampohen ose do të gdhenden në një pllakë metalit treguese, e fiksuar ne kapakun e transformatorit. Çelësi I rregullatorit te tensionit, duhet të ketë një vendosje të përshtatshme e ndertuar që të shmangë mundësinë e vendosjes te rregullatorit në një pozicion të ndërmjetëm. Lidhja e rregullatorit te tensionit me kapakun e transformatorit duhet te jete e tille qe te eliminoje rrjedhjen e vajit gjate shfrytezimit te tij.

#### **Terminalet**

Terminalet e kabllave të transformatorit do të projektohen duke pasur parasysh llojin e lidhjeve të përshkruara më poshtë:

- Në TM: kablllo alumini të izoluar
- Në TU: kablllo alumini të izoluar

Tipi i pjastrave pershtatese tip flamur jepet ne aneksin 1.

Daljet e peshtjellave nga brenda jashtë transformatorit duhet te realizohen me anën e izolatorëve kalimtare prej porcelani ngjyre kafe. Izolatorët duhet te jene për përdorim ne ambient te jashtëm.

### Instrumentet dhe aksesoret

Transformatorët duhet te pajisen se paku me instrumentet dhe aksesoret e mëposhtëm:

- Tregues i nivelit te vajit
- Termometër
- Ganxha për ngritje
- Tape në pjesën e sipërme për mbushje me vaj
- Rubinet për kullimi vaji në pjesën e poshtme
- Bulona për tokëzim ne pozicion diagonal
- Rrota që lëvizin në dy drejtime
- Targeta
- Logoja e OSHEE dhe Numri Serial do të stampohen ose gdhenden në pjesën e sipërme të kazanit
- Çelës I rregullatorit te tensionit
- Kapaku i tapës mbushëse me vaj
- Bazamenti metalik për montimin e kazanit dhe te rrotave
- Shkarkues ne forme briri.
- Pllakata ne shqip ne anën e tensionit te ulet;
- Shkronja te dukshme dhe te përhershme mbi mbulesë ne anën e tensionit te mesem 1U, 1V, 1W; Ana TU: 2U, 2V, 2W, 2N;
- Valvul sigurie ose ndonje zgjidhje tjeter teknike kunder shkaterrimit te kazanit;
- Pjastrat pershtatese sipas aneksit 1

### Vaji izolues

Transformatori do të pajiset me sasinë e duhur të vajit izolues me përmbajtje minerali të cilësisë së lartë. Vaji do të jetë në përputhje me Standardin SSH EN 60296 (Class 11).

Tabela 9-2: Të dhënat teknike - Transformatorët

NR.	Lloji i transformatorit	Trasformatore tre fazore te zhytur ne vaj, te mbyllur hermetikisht, per perdorim te brendshem ose te jashtem	
1	Standarti i aplikuar	SSH EN	60076
2	Fuqia nominale (Sn)	kVA	AN.1
3	Tensioni Nominal	kV	AN.1

Te dhena teknike te tjera

4	Numri i fazëve TM		3	per secilin tip te
5	Grupi i lidhjes		An.1	
6	Tensioni ne qark te shkurter 75 °C	%	4	
7	Frekuenca	Hz	50	
8	Kufijte e rregullimit te tensionit ne TM		±2 x 2,5%;	
9	Sistemi I tokezimit TM		I izoluar	
10	Tensioni i ulet nominal	V	400/230	
11	Numri I fazeve TU		3 faze/4 percjelles	
12	Sistemi I tokezimit TU		Direkt me token	
13	Tensioni qe duron ne frekuencen e fuqise per (1 min) TU	kV	3	
14	Lloji I ftohjes		ONAN	

transformatorit te fuqise tregohet ne shtesen 1 me poshte.

Grupi i lidhjes Dyn 5 mund te jete edhe Dyn 11.

### 9.1.3 HUMBJET

Transformoret kerkohen qe te kene humbje minimale.

Humbjet maksimale te pranueshme pa ngarkese dhe me ngarkese per secilin lloj transformatori tregohen ne aneksin 1 me poshte. Ofertat te cilat do te tejkalojne humbjet e transformatorit te kerkuara ne listen e te dhenave, duhet te refuzohen.

Ofertat me humbje te ulta ne transformator jame te preferueshme. Per kete arsye oferta me humbjet me te ulta ne transformator do te merret si reference dhe te gjithë humbjet e transformatoreve te tjere do te kapitalizohen me vlerat e vendosura me siper shtuar ne vleresimin e cmimit te ofertes per secilen oferte. (shiko 8.C)

### 9.1.4 TESTET

Transformoret e shperndarjes duhet te testohen si me poshte:

#### a) Llojet e testeve

- Testi I rritjes se temperatures (SSH EN 60076-2)
- Testi I dielektricitetit (SSH EN 60076-3)

#### b) Testet rutine



- Matja e rezistencës së peshtjelles
- Matja e raportit të tensionit dhe kontrolli i diagrames vektoriale.
- Matja e rezistencës së plote në qark të shkurtër dhe në humbje ngarkese
- Matja e rrymës në punës pa ngarkese.
- Testet rutine të elektrike (IEC 76-3)
- Prova me mbitemension, 50 Hz, 1 min TM në TU
- Prova me tension të aplikuar, 50 Hz, 1 min 50 kV

Te dhëna të tjera teknike për transformatorët e shpërndarjes 6 / 0.4 kV (përmasat dhe peshat janë orientuese)

Te dhëna	Njësia	Vlera
Fuqia	kVA	250
Humbjet P <sub>0</sub>	w	360
Humbjet P <sub>k</sub> (75°C)	w	2750
Tensioni L.SH në (75°C)	%	4
Niveli ndotjes akustike	Db (A)	50
Grupi lidhjes		Dyn 5
Dalja në primar		Bulon M12
Dalja në sekondar		Bulon M20
Dimensionet (LxWxH)	mm	1100x 850x1 400
Pesha totale	kg	1160

## 9.2 Paneli TU

### 9.2.1 Te përgjithshme

Materialet e mëposhtme duhet të jenë conform standarteve dhe specifikime të mëposhtme.

Te gjitha materialet janë ndertuar për të siguruar punë normale edhe në kushte klimatike të ndryshme. Ato duhet të punojnë normalisht edhe në kushtet e ndryshimit të ngarkesës dhe tensionit nën veprimin e lidhjes së hkurter ose avarive të tjera që mund të ndodhin në system.

Te gjitha materialet që përdoren për prodhimin e këtij produkti duhet të jenë të cilësive më të mira dhe të përshtatshme për punë edhe në kushte specifike. Ato duhet të kenë markim CE.

Panelet e tensionit te ulet me automat duhet te furnizohen te kompletuara dhe gati per tu montuar.

#### 9.2.1.1 Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje:

- Certifikata e fabrikes ISO 9001
- Te dhenat e tendertit si me poshte
- Te gjitha test raportet e fabrikes
- Diagramen elektrike
- Vizatimet (skicat)
- Manuali i perdorimi(skicat e instalimit)
- Markim CE te panelit dhe materialeve perberese

#### 9.2.1.2 Kushtet e sistemit

<b>Te dhena per sistemin</b>	<b>Njesia</b>	
Tensioni me I larte I sistemit	kV	0.66
Tensioni nominal	V	400/230
Frekuenca	Hz	50
Numri I fazeve	No	3 faze/4 percjelles
Sistemi I tokezimit		Direkt me token

#### **Kushtet atmosferike**

Temperatura maksimale e ambientit	40°C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Lageshtia relative maksimale	80%
Lartesia maksimale mbi nivelin e detit	1000m
Ndotja	mesatare

#### 9.2.1.3 Pershkrim, kerkesa dhe te dhena

Ky specifikim mbulon kerkesat per panelet e tensionit te ulet me automate, qe sherben per te lidhur pjesen e tensionit te ulet te trasformatorit te fuqise dhe furnizimin me energji elektrike te rrjetit te TU te shperndarjes .

Paneli I tensionit te ulet perdoret per ambient te brendeshem ose te jashtem sipas kerkeses.

Paneli TU duhet ndertuar dhe prodhuar sipas standartit IEC 60439-1.

Paneli duhet te perbehet nga komponentet e meposhtem(shih skemen perkatese ne fund te materialit).

- 1 (nje) boks metalik me metal anti koroziv, me qendrueshmeri te larte termike dhe kundra zjarrit , me dere
- Automatet e TU, sipas tabeles dhe skemes me poshte
- 3(tre) zbara bakri per fazat, 1(nje) zbare bakri per neutrin dhe 1(nje) per token,
- Vrime per linjen hyrese per automatin tre polar (shih spec teknike te automatit)
- Vrime per linjat dalese te automateve tre polar
- 3 (tre) transformatore rryme monofaze tip toroide, rryma ne primar ne perputhje me rrymen e transformaterve te fuqise (pjesa e tensionit te ulet), rryma ne sekondar 5A, fuqia ne dalje 5VA, klasa e saktetise 0.5 FS 10,

- 1(nje) mates smart 230/400V, 5 A,
- 1(nje) miniautomat trefazor 16A, 400 V per ndricimin e ambientit dhe prize, kl B
- 1(nje) miniautomat trefazor10A, 400V per qarqet e tensionit te matesave, kl C
- 1(nje) prize shuko 16 A
- 1(nje) llambe per ndricim paneli
- Nje llambe modulare tre fazore LED per identifikimin e prezences se tensionit

Shenim: Per dimensionet e vrimave per hyrjen dhe daljen e kablllove referohu seksioneve te linjave ne tabelen e te dhenave teknike te meposhtme

Paisjet e panelit te tensionit te ulet duhet te montohen ne boks qe ne fabrike. Paneli duhet qe te kete mundesi per tu montuar ne mur ose ne dysheme. Paneli duhet te kete dyer te levizshme dhe pas tyre pllake mbrojtese izoluese, zjarduruese, transparente me qellim mbrojtjen nga kontaktet aksidentale. Dritaret per leven e automateve duhet te projektohen per perdorimin manual ON/OFF.

Anet e boksit duhet te jene te mbyllura. Dera duhet te jete me bllokim mekanik dhe te kete mundesi per tu mbyllur me element te sigurie i cili eshte pjese e panelit. Pjese e panelit jane edhe te gjitha aksesoret e montimit. Paneli eshte kundra zjarrit (klasa B), mbyllja e dyereve eshte sipas principit te tri pikave te energjise.

Ne panel duhet te parashikohen vrimat per hyrjen dhe daljen e kablllove. Vrima e kabllit dales do te parashikohet ne funksion design prodhimit qe do te percaktohet nga investitori ne fazen e porosise . Per hyrjen dhe daljen e kablllove duhet te parashikohen cable glands ne perputhje me seksionet e kablllove perkatese.

Montimi perfshin te gjitha lidhjet midis percjellesave dhe paisjeve te montuara ne panel. Zbarat duhet te jene te sheshta, keshtu ajo mund te lejoje lidhjen e kablllove me bashkueset.

Paneli duhet te kete zbaren e tokes me zbare bakri dhe terminalin e tokes me nje bulon M12 plus dado. Izolatoret ne zbarat e tensionit te ulet duhet te jene porcelan ose "epoxy resin" material i derdhur epox ne gjendje qe te duroje forcat elektrodinamike qe mund te vijne si rezultat i rrymave maksimale te LSH. Lustra duhet te jete e bute dhe solide, dhe duhet te mbuloje te gjitha pjeset e ekspozuara te izolatorit dhe mos te lejoje plasaritjet dhe carje.

Zbarat e tensionit te ulet duhet te jene solide dhe pa defekte.

Ne siperfaqen e panelit te tensionit te ulet duhet te shenohet e stampuar logoja e OSHEE si dhe nje pllakate paralajmruese me rrezikun per jeten, me simbolin dhe shenimin "RREZIK VDEKJE 400V".

Ne nje pjese te dukshme te tij, duhet te montohet etiketa (targeta) ku te shenohen te dhenat kryesore si dhe ato identifikuese te tij, ne perputhje me standartet perkatese.

Ne panel duhet te parashikohet hapësire per montimin ne prespektive edhe te nja automati tjetër per dalje rezerve si dhe per transformatoret e rrymes perkatese.

Gjithashtu kompozimi i panelit duhet te behet ne menyre te tille qe ne prespektive te kete mundesi te montohen trasformatore rryme edhe per daljet me qellim qe te behet bilanci i tyre.

Pjeset percjellese te rrymes brenda panelit duhet te jene te sistemuara dhe te mbuluara me kapak plastic transparent.

Ne hapësiren e lire te panelit (ne zonen ku nuk ka as paisje, as zbara, as ku parashikohet te lidhen kablllo) duhet te parashikohet :

1. Hapesire per montimin e nje Paisje Speciale per mbrojtjen nga mbitensionet ( SPD ) me permasa sipas kerkeses se porositesit .
  2. Hapesire per montimin ne prespektive te paisjeve telekomunikuese
  3. Per hyrjen e kablllove duhet te parashikohen cable glands te rakordushme per seksione te ndryshme.
- Per sa me siper ne kete pjese duhet te montohet shine DIN RAIL me mundesi per te levizur vertikalisht

sipas nevojës.

Qarqet duhet të kontrollohen në çdo panel për:

- Lidhjet korrekte të përcjellesave
- Testi i qëndrueshmërisë për frekuencë të fuqisë 50 Hz, 1 sec., 3 kV

Duhet të sigurohen dritare për ajrim pa cenuar shkallën e mbrojtjes IP të kërkuar.

Tabela 9-3: Të dhënat teknike - Paneli TU

NR.	Lloji i transformatorit	Njesia	Te dhenat teknike
1	Standarti i aplikuar	SSH EN	50274:2002
2	Tensioni nominal	V	230/400
3	Frekuenca	Hz	50
4	Numri i fazeve		3fazes/4përcjelles
5	Tensioni që duron për 1 min në frekuencën e fuqisë	kV	3
6	Tensioni impulsiv i shkarkimeve që duron 1.2/50µs	kV	8
7	Rryma e lidhjes së shkurter	kA	20
8	Rezistenca në rastin e një goditje	Xhaul	20
9	Testi në të nxehtë të përcjellesave	°C	750
10	Diapazoni i temperaturave	°C	-20 deri +50
11	Lageshtia	%	90
12	Izolimi		Dyfish
13	Materiali i aksesoreve dhe boksit		Metalik
14	Shkalla e mbrojtjes për ambient të brendshëm/të jashtëm		IP44/IP65
15	Ngjyra e panelit		RAL7035
16	Lloji i instalimit		Vertikal, i fiksuar
17	Ambienti i montimit		I brendshëm/I jashtëm

Tabela  
9-4:  
Të  
dhënat

teknike - Paneli TU

Tipi i panelit TU [mm]	Seksioni terthor I linjës hyrese [mm <sup>2</sup> ]	Dimensioni i panelit	Rryma e lidhjes së shkurter ( KA )	Fuqia e Transformatorit [kVA]
3 automate 1x200+2x100	4x95 AL	a=750mm b=750÷850mm c=250÷300mm	20	100
4 automate 1x320+(1x160A+2x100 A +1 vend për automat rezervë )	3x120+1x70 AL	a=750mm b=750÷850mm c=250÷300mm	20	160
Varianti I 3 automate 1x400+(2x250 A+ 1 vend për automat rezervë ) Varianti II 4 automate 1x400+( 3x160A+ 1 vend për automat rezervë )	3x240+1x120 AL	a=750mm b=750÷850mm c=250÷300mm	20	250

5 automate 1x800+4x200 A + 1 vend per automat rezerve )	2x(3x185+1x95) AL	a=880÷900mm b=1600÷1800m m c=350÷400mm	20	400	Per
5 automate 1x1000+(4x250 A + 1 vend per automat rezerve )	3x(3x240+1x120) AL	a=880÷900mm b=1600÷1800m m c=350÷400mm	20	630	

panelet e transformatoreve 250 KVA e me shume, furnizimi i tyre do te behet me kablo nje fazore duke respektuar numrin dhe seksionin e dhene me lart. Te gjithë kabllot kane izolacion XLPE.

Kompozimi panelit duhet te behet ne menyre te tille qe te respektohen standartet e panelit ne teresi, standartet e punes se paisjeve, sigurimi teknik e tje. Kujdes duhet te tregohet me ventilimin ne menyre qe temperatura maksimale ne pjesen e siperme te panelit te mos kaloje 60°C.

Ne raste te vecanta, cilesuar ne kerkese, paneli mund te kompozohet edhe ndryshe por duke respektuar kerkesat e ketij specifikimi. Varianti perfundimtar i prodhimit te panelit do te vendoset pas miratimit nga ana e bleresit.

#### 9.2.1.4 Perdorimi

Paneli i tensionit te ulet eshte ndertuar per tu montuar ne mur dhe dysHEME, per te lidhur nje linje hyrese dhe linjat dalese dalese me seksion deri 240 mm<sup>2</sup>.

Paneli TU perdoret per ambient te brendeshem/te jashtem (sipas kerkeses).

#### 9.2.1.5 Paketimi

Materialet paketuese duhet te jene sipas SSH EN 13430 dhe SSH EN 13431. Ato duhet te jene te riciklueshme dhe nuk duhet te permbajne substance radioactive , kancerogjene ose substance te tjera te rrezikshme per shendetin dhe mjedisin. Pjese e paketimit eshte nje tabelë pershkruese e cila duhet te perfshije minimalisht informacionin e meposhtem:

Fabrika, lloji i panelit, numri i copeve, dimensionet, pesha.

#### 9.2.1.6 Testet

##### Llojet e testeve

- Prova e deformimit,
- Prova dielektrike
- Prova per kufinjte e temperaturave,
- Fortesia e vidave dhe dadove,
- Shkalla e mbrojtjes,
- Resiztenca ne nxehtesi.

##### Testet rutine

- Inspektime te pergjitheshme
- Shkalla e mbrojtjes
- Fortesia e vidave dhe dadove
- Resiztenca ne nxehtesi

### 9.2.1.7 Automat tre fazor TU(mccb)

#### Te dhena te pergjithshme

Ky specifikim paraqet kushtet e pergjitheshme teknike per blerjen dhe pranimin e automateve TU tre fazore, me tre pole te cilet perdoren ne rrjetat e tensionit te ulet si celesa, si paisje mbrojtese. Paisja duhet te jete konform standarteve SSH, EN, ose IEC. Paisja duhet te kete markim CE Pajisjet duhet te ndërtohen për të siguruar funksionimin e sigurte, mirembajtje, mbrojtjen ne punë dhe do të shënohet me një tregues të dukshem të sigurisë.

#### Ilustrimi

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)



Figura 9-1: Automat 3 fazor TU

#### Kerkesa te detyrueshme

Eshte e detyrueshme qe furnizuesi te siguroje dokumentat e meposhtme.

- Certifikat e fabrikes ISO 9001
- Te dhena teknike sic kerkohen me poshte
- Karakteristikat e komutimit per automatet
- Te kene marketim CE

#### Kushtet e sistemit

Te dhena per sistemin	Njesia	
Tensioni me I larte I sistemit	kV	0.66
Tensioni nominal	V	400
Frekuenca	Hz	50
Numri I fazeve	No	3 faze/4 percjelles
Sitemi I tokezimit		Direkt ne toke

#### Kushtet atmosferike

Temperatura maks. e ambientit	40oC
Temperatura min. e ambientit	-10 oC
Lageshtia relative maksimale	80%
Lartesia maks. mbi nivelin e detit	1000m
Ndotja	mesatare

#### Pershkrim, Kerkesa dhe te Dhena

Ky specifikim mbulon kerkesat per automatet tre fazore te TU me tre pole me qellim qe te perdoren ne rrjetat e tensionit te ulet(kryesisht ne kabina transformacioni) si celesa dhe si element mbrojtjes. Automatet tre fazore TU duhet te jene per perdorim te brendeshem.

Tabela 9-5: Specifikimet teknike – Automat 3 Fazor TU

1	Specifikimet	Njesia	Vlera
2	Numri I poleve		3
3	Ryma nominale ne 30°C, In	A	100
4	Kufijte e regullimit te rymes nominale 30°C, Ir	A	(0.6-1.0) x In
5	Rryma max qe nuk shkakton ckycje (Int)	A	1.13
6	Qendrushmeria ndaj rrymes LSH 1 sek	KA	20
7	Tensioni nominal	V	400
8	Tension I izolimit	V	500
9	Frekuenca	Hz	50
10	Numri I cikleve elektrike te punes		10000
11	Kurba e komutimit		B

1	Specifikimet	Njesia	Vlera
2	Numri I poleve		3
3	Ryma nominale ne 30°C, In	A	160
4	Kufijte e regullimit te rymes nominale 30°C, Ir	A	(0.6-1.0) x In
5	Rryma max qe nuk shkakton ckycje (Int)	A	1.13
6	Qendrushmeria ndaj rrymes LSH 1 sek	KA	20
7	Tensioni nominal	V	400
8	Tension I izolimit	V	500
9	Frekuenca	Hz	50
10	Numri i cikleve mekanike te punes		25000
11	Numri I cikleve elektrike te punes		10000

1	Specifikimet	Njesia	Vlera
2	Numri I poleve		3
3	Ryma nominale ne 30°C, In	A	250
4	Kufijte e regullimit te rymes nominale 30°C, Ir	A	(0.6-1.0) x In
5	Rryma max qe nuk shkakton ckycje (Int)	A	1.13
6	Qendrushmeria ndaj rrymes LSH 1 sek	KA	20
7	Tensioni nominal	V	400
8	Tension I izolimit	V	500
9	Frekuenca	Hz	50
10	Numri i cikleve mekanike te punes		25000
11	Numri I cikleve elektrike te punes		10000

1	Specifikimet	Njesia	Vlera
2	Numri I poleve		3
3	Ryma nominale ne 30°C, In	A	400

4	Kufijte e regullimit te rymes nominale 30°C, I <sub>r</sub>	A	(0.6-1.0) x I <sub>n</sub>
5	Rryma max qe nuk shkakton kycje (Int)	A	1.13
6	Qendrushmeria ndaj rymes LSH 1 sek	KA	20
7	Tensioni nominal	V	400
8	Tension I izolimit	V	500
9	Frekuenca	Hz	50
10	Numri i cikleve mekanike te punes		20000
11	Numri i cikleve elektrike te punes		8000

## 9.3 SIGURESA TM PER AMBIENTE TE JASHTME 6, 10, 20, 35 KV

### 9.3.1 1.1 Kerkesa te pergjithshme

Ky specifikim percakton kushtet e pergjithshme teknike per blerjen dhe pranimin e siguresave TM per ambiente te JASHTME. Produkti duhet te kontrollohet ne perputhje me Standartet me te fundit SSH, EN ,IEC ose ekuivalenteve te tyre. Ai duhet te ketemarkim CE.

#### Ilustrim

(Ilustrimet dhe dimensionet jane orientuese)





### 9.3.2 Kushtet e sistemit

#### Te dhena per sistemin

Specifikime	Njesia	Sistemi TM
Tensioni nominal I sistemit	kV	6/10/20/35
Tensioni me i larte per paisjet	kV	7.2/12/24/40.5
Frekuenca	Hz	50
Numri I fazeve		3
Sistemi I tokezimit		I izoluar
Rryma maksimale per lidhje te shkurter ne/1 sek	kA	20

#### Kushtet e sistemit

Temperatura maksimale e ambientit	40 °C
Temperatura mesatare maksimale ditore	30 °C
Temperatura minimale e ambientit	-10 °C
Temperatura maksimale ne diell e siperfaqeve horizontale te ekspozuara	60 °C
Lageshtia relative maksimale ( ne toke )	95 %

Lageshtia relative maksimale ( ajer)	80 %
Larteisa maksimale mbi nivelin e detit	<1000 m

### 9.3.3 Pershkrim, Kerkesa dhe te Dhena

Lidhjet e siguresave HRC duhet te ndertohen dhe testohen sipas Standarteve SSH EN 60282-1, dhe DIN 43625. Dimensionimi i siguresave do te jete sipas DIN 43625.

Siguresat TM duhet te kene karakteristikat e meposhtme :

- Ryme minimale te ulet te shkeputjes ,
- Humbje te ulta te fuqise,
- Tension te ulet te harkut,
- Kapacitet te larte te ckycjes,
- Kufizim te rrymes se larte

Siguresat jane ndertuar per temperature ambienti nga  $-30^{\circ}\text{C}$  to  $+40^{\circ}\text{C}$ , dhe per lageshti relative te ajrit deri ne 100%.

Izolatoret mbeshtetes per keto siguresa e kane gjatesine e ruges se shkarkimit me te madhe se siguresat per ambient te brendshem dhe forma gjeometrike e tyre eshte e tille qe te lejoje shkeputjen e

ujit dhe jo rjedhjen e vazhdushme te tij drejt bazamentit.

Ne strukturen e sigureses perfshihen emri I prodhuesit, viti I prodhimit dhe parametra teknik.

Ndertimi I fishekeve te siguresave TM per kufizimin e rrymes jane dhene me poshte:

- Trupi I fishekut ka material porcelan te nje cilesie te larte te glazuar me ngjyre kafe I tipit C120.
- Kokat e kontaktit te veshura me Ni / Ag jane te zmusuara te vendosura ne trupin prej porcelani. Izolimi fizik I sigureses midis ketyre komponenteve eshte prej materiali te vecante qe eshte rezistente ndaj temperaturave te larta.
- Mbajtsja ne forme ylli prej porcelani e elementit shkrires te bandazhuar reth saj eshte vendosur ne menyre koaksiale ne trupin e sigureses.
- Elementi shkrires eshte I perbere nga argjent I paster, ne menyre qe te kete mundesi te mbaje seksionin me te ulet te mundshem qe eshte themelor per funksionimin normal te sigureses kur eshte e nevojshme. Elementi shkrires eshte salduar(pikuar) ne te dyja kokat e kontakteve me nje teknike speciale.
- Pjesa mbajtjese e trupit te sigureses eshte e mbushur me kokerriza homogjene kuarci e cila luan nje rol te rendesishem ne shuarjen e harkut.

Bazamentet e jashtme te siguresave perdoren ne rrjetat e TM, zakonisht kur lidhen transformatoret ne linje.

Bazamentet e jashtme te sigureses TM ofrojne zgjidhje te forte dhe te besueshme per sistemin me tension te mesem. Bazamentet 1 polar te siguresave te jashtme perdoren ne sistemin me tension nga 6 kV ne 35 kV me rryma nominale 2 deri 300 A.

Bazamentet e TM te siguresave te jashtme perbehen nga nje pol. Bazamenti I sigureses me nje pol perbehet nga nje baze, nje numer I caktuar izolatoresh mbeshtetes dhe nje numer I caktuar I mbajteseve te siguresave. Te gjitha pjeset metalike te bazamentit te sigureses jane te galvanizuara. Te gjitha pjeset nen tension( kontaktet mbajtes te fishekut dhe kontaktet e terminaleve) te bazamentit te sigureses jane te perbera nga baker elektrolitik I galvanizuar me argjend .Kontaktet e bakrit jane te shtrenguara nepermjet dy unazave suste me qellim qe te realizojne kontaktin e duhur dhe mbajtje te sigurte te fishekut te sigureses. Ndertimi I ketij kontakti mirembahet lehtesisht.

Kontaktet jane me vete pastrim, e cila ben qe bazamentet e sigureses te jene te pershtatshme per

instalim ne te gjitha zonat me kushte klimatike te ndryshme.

Bazamentet e sigureses pajisen me izolator ne perputhje me specifikimet IEC, ANSI ose DIN.

Bazamentet e siguresave jane plotesisht te montueshme dhe te rregullueshme. Ndertimi I tyre lejon montimin ne te dyja pozicionet , vertikal dhe horizontal.

Ndertimi I bazamenteve eshte I tille qe lejon te montohen ne vend lehtesisht pa qene nevoja per ndonje paisje speciale.

Bazamentet e siguresave te jashtme jane ndertuar dhe testuar ne perputhje me standartet me te fundit IEC.

#### Te gjitha specifikimet e pergjithshme te siguresave

Tensioni nominal (kV)	Rryma nominale (sipas kerkeses) (A)	Qendrushmeria ndaj tensionit me frekuencen e fuqise	Qendrushmeria ndaj tensionit impulsiv	Perdorimi
6	Deri 300 A	$\geq 20$	$\geq 60$	jashtem
10	Deri 200 A	$\geq 28$	$\geq 75$	jashtem
20	Deri 100 A	$\geq 50$	$\geq 125$	jashtem
35	Deri 40 A	$\geq 70$	$\geq 170$	jashtem

#### Zgjedhja e sigureses per mbrojtjen e transformatorit

Vlera nominale e tensionit ne sigures dhe transformator (kV)	Fuqia e transformatorit (kVA)					
	50	100	160	250	400	630
	Rryma nominale e fishekut te sigureses (A)					
6	16	25	31.5	50	63	100
10	10	16	25	31.5	50	63
20	10	10	16	20	25	40
35	10	10	10	10	16	25

Tabela eshte llogaritur sipas standarteve SSH EN 60282-1 and SSH EN 62271-105, DIN 43625 .

Kushtet e punes se transformatoreve jane supozuar si me poshte.

- Rryma e thithjes e manjetizimit –  $12 \times I_n$  gjate 100 ms,
- Tensioni I lidhjes se shkurter te transformatorit sipas SSH EN 60076-5,

- Kushtet standarte te ambientit te punes se sigureses

**Te dhena teknike**

**Specifikime Teknike – Siguresa TM per Ambiente te Jashtme**

Rated voltage Un(kV)	Rated current In(A)	Dimension e (mm)	Dimension c (mm)	Rated breaking capacity (kA)	Minimum breaking current (A)	Cold resistance 20 °C (mΩ)	Power dissipation (W)	Weight approx. (kg)
7.2	2	192	53	20	8	700	5	1.2
	6				24	280	12	
	10				50	110	15	
	16				64	85	22	
	20				92	42	24	
	25				110	37	30	
	30				145	27	35	
	40				160	20	45	
	50				250	16	55	
	63				360	12	62	
80	450	7	63					
12	2	292	53	20	8	1200	11	1.7
	6				24	400	14	
	10				50	160	22	
	16				64	95	25	
	20				92	62	32	
	25				110	48	39	
	30				145	40	40	
	40				160	29	85	
	50				250	25	75	
	63				360	18	95	
80	450	10	120					
24	2	442	53	20	8	2100	22	2.2
	6				24	500	20	
	10				50	275	40	
	16				64	145	55	
	20				92	90	60	
	25				110	75	65	
	30				145	60	70	
	40				160	55	110	
	50				250	40	115	
	63				360	27	140	
80	450	18	225					
			75	16				4.8

36	2	537	53	20	8	2800	25	2.8
	6				24	700	20	
	10				50	320	40	
	16				64	160	85	
	20				92	110	80	
	25				110	95	90	
	30				145	80	195	
	40				160	75	227	
	50				250	46	220	
	63				360	38	198	
80	450	28	260	5.2				



Dimensioni i diametrit “C” është orientues dhe jo precaktues. (Sipas standartit, në funksion të rrymave të fillit shkrires, ky dimension mund të jete edhe ndryshe).

#### 9.3.4 Perdorimi

Siguresat e TM për kufizimin e rrymes janë elemente të sistemit të cilat janë gjerësisht të përhapura në sistemin TM për të mbrojtur linjat ajrore, kabllot e fuqisë, motorat, transformatorët, grupet e kondensatoreve, ndaresit dhe celsat kundër rrymes së LSH mbi vlerat e lejuara.

#### 9.3.5 Transporti dhe magazinimi

Siguresat duhet të vendosen në kuti kartoni të ndara midis tyre ose mund të vendosen në kuti druri. Kur magazinimi i tyre është i nevojshëm, duhet të tregohet kujdes nga goditjet dhe demtime nga faktore të tjera.

#### 9.3.6 Standartet referuese

Siguresat e TM për kufizimin e rrymes prodhohen sipas standarteve të mëposhtme ose ekuivalenteve të tyre.

- SSH EN 60282-1 Siguresat e tensionit të lartë - Pjesa 1: Siguresat me kufizimin e rrymës (High-voltage fuses - Part 1: Current-limiting fuses)
- IEC 60787 Udhëzues tutorial dhe aplikimi për siguresat e tensionit të lartë (Tutorial and application guide for high-voltage fuses)
- DIN 43 625 Siguresat e tensionit lartë, me tension nominal 3.6 deri 36 kV (dimensionimi i siguresave) (High-voltage fuse-links, rated voltages 3,6 to 36kV (fuse-link dimensions))

- DIN 43 624: Siguresat e tensionit larte, me tension nominal 3.6 deri 36 kV(Bazat e siguresave njepolare)(High-voltage fuse-links, rated voltages 3/3,6 to 30/36kV (single-pole bases)

### 9.3.7 Testet

Testet fizike dhe elektrike do te zbatohen ne perputhje me SSH EN 60282-1 dhe IEC 60 787 ose standartet ekuivalente.

Nder testet mund te permendim:

- Testi I aftesise se nderprerjes se qarkut(kapacitetit ckyces)
- Testi ritjes se temperatures
- Kurba e vartesis se rryme-kohe

### 9.3.8 Sherbime te tjera

Furnizuesi duhet te siguroje 3 dokumentat e meposhtme:

- Karakteristikat e komutimit,
- Vizatimet strukture
- Manual perdorimi

Date, seal and Signature of Tenderer:				
<b>Tabela e te dhenave (DATA SCHEDULES )</b>				
ITEM	DESCRIPTION	UNIT	func. Guarantee	
I	Siguresa TM per kufizimin e rrymes (MV Limiting Current Fuse)			

Specifikime Teknike – Siguresa TM per Ambiente te Jashtme

1	Te dhena te pergjitheshme (GENERAL DATA)		
1.1	Prodhuesi (Manufacturer)		
1.2	Vendi prodhimit dhe proves (Place of manufacture and test)		
1.3	Type Designation		
1.4	Srandarti aplikuar (Applied standard)		
2	Te dhena (Data)		
2.1	Tensioni nominal (Rated voltage)	kV	
2.2	Tensioni me i larte i sistemit (Highest system voltage)	kV	
2.3	Frekuenca (Rated frequency)	Hz	
2.4	Ryma nominale (Rated current (In)	A	
2.5	Rryma max. lejuar (pik) (Maximum let-through current (peak)	kA	
2.6	Nr. fazeve (No. of phases )		
2.7	Qendrushmeria ndaj tensionit te shkarkimeve (Rated lightning impulse withstand current) 1.2/50 $\mu$ s	kV	
2.8	Qendrushmeria ndaj tensionit me frekuencen e fuqise (Rated power frequency withstand voltage, 50Hz)	kV	
2.9	Rryma per kohe te shkurter 1 sek (Rated short circuit current (1 s)	kA	
2.10	Tipi i instalimit (Type of installation)		

Meqen se termat jane teknike, baze do te meret emertimi ne anglisht.

## 9.4 Shtylla beton arme te centrifuguara

### 9.4.1 Të përgjithshme

Shtyllat e betonit të standardizuara ne kete specifikim, do të përdoren në ndërtimin e linjave ajrore te TM dhe TU. Kontraktori do të optimizojë projektin e linjës duke përzgjedhur kampaten nominale, gjithmone duke marrë në konsideratë kushtet e projektimit të specifikuara më poshtë.

Për trasene e linjes në një vend të hapur për të kapërcyer pengesa të ndryshme, do të përdoren shtylla me lartësi të përshtatshme. Shtyllat duhet te jene me seksion rrethor me nje vrime te qenderzuar mire pergjate gjithe gjatesise se shtylles dhe me diameter qe ritet ne menyre uniforme nga maja deri ne fund te shtylles.

Cilësia e betonit dhe armimi i tij prej çeliku të përforcuar do të jetë sipas standardeve. Sipërfaqja e jashtme e betonit do të jetë e sheshtë, pa brima ose të çara, siç është përcaktuar në standarte. Vrime ne maje te shtylles duhet te jete e mbyllur me kapuc betoni per te mos lejuar futjen e ujit.

Kapaciteti(momenti) i shtyllës shprehet me ngarkesën ne perkulje të aplikuar poshtë kokës së shtyllës, siç e përcakton standardi.

Gjatësia e shtyllës duhet të jetë 9 m, 10 m dhe 12 m. Te kene marketim CE.

TE DHENA TE PERGJITHESHME		
Tensioni nominal	kV	10 ose 0.4
Frekuenca	Hz	50
Tensioni me i larte I sistemit	kV	12 ose 0.66
Tempertaura maksimale per llogaritjen e shigjetes se		60
Temperature minimale	°C	-20
Trashesia e akullit ne percjelles	mm	10
Shpejtesia maksimale e eres	m/s	35
Mesataraja e rreshjeve vjetore	mm	1000-1500

#### 9.4.2 Detaje teknike

Ky specifikim mbulon projektimin, materialet, prodhimin, inspektimin, testimin, skicimet, transportin dhe dorëzimin e shtyllave të betonit te drejta, te paratensionuara 9, 10 dhe 12 m.

#### 9.4.3 Standarded

Projektimi, prodhimi dhe testimi i shtyllave duhet te jete ne perputhje me standartet e me poshtme:

- SSH EN 12843 Produkte të parafabrikuara të betonit - Shtyllat dhe traret(Concrete prefabricates- masts and poles)
- SSH EN 10080 Concrete reinforcement steel- Reinforcement steel suitable for welding- General terms(Çelik për përforcimin e betonit - Çelik i përforcuar i saldueshëm - Të përgjithshme)
- SSH EN EN 12620 Agregatet e betonit(Concrete aggregate)
- SSH EN EN 1097- 1 Provat për vetitë fizike dhe mekanike të agregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës ndaj fërkimit (mikro-Deval)(Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 1: Determination of the resistance to wear (micro-Deval)
- SSH EN 1097-2 Provat për vetitë mekanike dhe fizike të agregateve - Pjesa 2: Metoda të përcaktimit të rezistencës ndaj copëzimit (Tests for mechanical and physical properties of aggregates - Part 2: Methods for the determination of resistance to fragmentation)
- SSH EN 1367- 1 Prova për vetitë termike dhe klimaterike të agregateve - Pjesa 1: Përcaktimi i rezistencës në ngrirje dhe shkrirje (Tests for thermal and weathering properties of aggregates - Part 1: Determination of resistance to freezing and thawing)



- SSH EN 196- 1 Metoda prove për çimento - Pjesa 1: Përcaktimi i fortësisë (Methods of testing cement - Part 1: Determination of strength)
- SSH EN 196- 7 Metoda prove për çimento - Pjesa 7: Metoda për marrjen dhe përgatitjen e mostrave të çimentos(Methods of testing cement - Part 7: Methods of taking and preparing samples of cement)
- SSH EN 197-1 Çimento - Pjesa 1: Përbërja, karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot e zakonshme (Cement - Part 1: Composition, specifications and conformity criteria for common cements)
- SSH EN 197-2 Çimento - Pjesa 2: Vlerësimi i konformitetit(Cement - Part 2: Conformity evaluation)
- ISO 1920- 1 Testimi i betonit - Pjesa 1: Marrja e mostrës së betonit të sapo përgatitur(Testing of concrete - Part 1: Sampling of fresh concrete)
- ISO 1920-3 Testimi i betonit - Pjesa 3:Marrja dhe trajtimi i mostrës(Testing of concrete - Part 3: Making and curing test specimens)
- ISO 1920-4 Testimi i betonit - Pjesa 4:Rezistenca e betonit të ngurtësuar(Testing of concrete - Part 4: Strength of hardened concrete).

#### 9.4.4 Testimi

Testet per betonin duhet te behen ne perputhje me EN 13369:2004 klauzola 5.1

#### Matja e dimensioneve

Dimensionet do te maten me paisje qe kane nje saktesi  $\pm 1\text{mm}$  me perjashtim te gjatesise se shtylles qe do te matet me saktesi  $\pm 0,5\%$ . Pajisjet matëse dhe metodat e testimit do të përshkruhen në dokumentet e kualitetit të prodhuesit.

#### Veshja me beton

Testimi i betonit veshes perforcues, mund të jenë shkatërruese ose jo-shkatërruese, do të kryhet me një saktësi prej  $\pm 2,0\text{mm}$ . Metoda e përdorur për këtë testim do të përshkruhen në kontrollin e prodhimit fabrikë.

#### Rezistenca mekanike

Testi eshte i perbere nga:

- Matja e deformimit gjate aplikimit te momentit te perkuljes

- Ngarkesa deri ne shfaqjen e plasaritjen e betonit (load when the first transversal crack appears in case of pre-stressed concrete )
- Ngarkesa perfundimtare (ultimate load)
- Ngarkesa perfundimtare ne perdredhje ( ultimate torsional load)

### Testi ne perkulje

Testi do te kryhet ne nje shtylle horizontale, mbeshtetur fort, te shtrire ne nje nje support te levizshem per te shmangur efektet per shkak te peshes dhe te lejoje levizjen e lire te saj. Nëse nuk definohet as në deklaratën e prodhuesit apo në kërkesat e blerësit, ngarkesa do të zbatohet në  $90^\circ (\pm 5^\circ)$  te aksit qendror te shtylles, jo te deformuar. Shpejtesia e ngarkimit, aplikuar nen kontrollin e forcave duhet te jete i kufizuar ne 100N/s pa ndonje shok apo impakt. Një saktësi prej  $\pm 3\%$  është e nevojshme për ngarkesat e aplikuar të testit dhe në deformimet e matura.

### Testi elasticitetit

#### Testi I kapacitetit mbajtës

#### Testi perdredhjes

Testi do të kryhet në një shtyllë në pozicion horizontal. Maja e shtylles do te jete e lire dhe deformimi duhet te shmanget. Testi gjatesise embedment eshte percaktuar ne kerkesat e bleresit ose ne deklaraten e prodhuesit. Ajo përcakton seksion kryq embedment. Rritja e momentit rrotullues do te kufizohet ne 100Nm/s pa ndonje shok apo impakt. Një saktësi prej  $\pm 3\%$  do të kërkohet mbi ngarkesat e aplikuar të testit.

#### 9.4.5 Zgjedhja e shtyllave

#### Shtylla ndermjetese (mbajtese)

Një shtyllë ndermjetese përdoret kur përcjellësit/telat janë varur ne shtyllë dhe tensioni mekanik është i njëjtë nga të dy anët. Në këtë rast, supozohet që shtylla të perballoje nje forcë në rënie (perpendikular poshte) dhe një forcë anësore, por jo një forcë gjatësore. Këto shtylla përdoren aty ku linja ajrore vazhdon në mënyrë lineare ose kthehet në një kënd të ngushtë. Në raste të tjera, do të përdoret shtylla ankerore.

Aplikimi :

Linja lineare ose këndore me  $\text{kend} \leq 200$  Lloji i shtyllës 9/6, 10/6 or 12/6

---

---

### **Shtyllat Tensionuse/Ankerore/ Fundore/Shtyllat pa vazhdim (Ankerore Fundore) (Dead-end poles )**

Shtyllat në fund të një seksioni linear të linjës, aty ku linja mbaron ose merr kënd në një drejtim tjetër quhen shtylla tensionuse/Ankerore/Fundore/Ankerore Fundore. Këto shtylla duhet të perballojnë forcat gjatesore të seksioneve dhe gjatesive me te medha te percjellesave. Zakonisht, ato kane nje konstruksion ndertimi me te rende.

Aplikimi:

këndi ( >200) - (≤600)

Lloji i shtyllës 9/10, 10/10 or 12/10

këndi (>600) - (≤ 900) ose shtylla ankerore , fundore, ankerore fundore

Lloji i shtyllës 9/15, 10/15 or 12/15

#### **9.4.6 Ndertimi**

Shtyllat duhet të jenë në gjendje t'i rezistojnë të gjitha rasteve të specifikuara të ngarkesës, duke përfshirë erën mbi shtylla dhe tërheqjen dytësore nga devijimi, shmangia dhe lëvizja e bazamentit. Shtylla do t'i rezistojnë ngarkesave pa pasur demtime si dhe duke mos tejkalar limitet e devijimeve te specifikuara.

Shtyllat do t'i rezistojnë kushteve të ngarkesës, duke përfshirë edhe faktorë specifik të ngarkesës. Projektimi i shtyllës do të përfshijë toleranca për faktoret e ngarkesës nga trajtimi, transporti dhe ngritja pa demtime e saj, si dhe deformimin e përhershëm apo dëmtimin e shtyllës.

Shtyllat do të projektohen në mënyrë të tillë që qendrueshmeria ne thyerje e shtyllës e tejkalon forcën e kerkuar, e cila llogaritet nga ngarkesat e sherbimit të aplikuar në shtyllë.

#### **9.4.7 Materialet**

Te gjitha ankoruset e siguruara nga fabrika duhet te jene te galvanizuara ne te nxehte ose material jo korroziv. Pllakat kadmium dhe material alumini nuk duhen perdorur.Te gjitha materiet duhet te jene jo korrozive prodhuar enkas per kete qellim bazuar ne rekomandimet e fabrikes. Nese prodhuesi I konsideron heqjen e paisjeve levizese te nevojshme apo te pershtatshme, ato mund te jene te derdhura ne shtyllle me paisje levizese.

Betoni duhet te kete minimum pas 28 ditesh nje fortesi ne shtypje prej 5,000 psi me nje vlere maksimum te permbajtjes se uje-cimento 0.40. Fortesia me e madhe dhe vlere me e vogel uje- cemento kompensojne kerkesat per celikun.

Agregati I holle duhet te jete rere natyrale, me grimca te pastra te forta, te ashpra dhe me te gjitha specifikimet e perfshira me poshte. Agregati duhet te jete i nje klase te mire.

Agregati I ashper duhet te jete I paster, me gure te thyer dhe I nje cilesie te mire. Agregati duhet te jete I lagur me uje para se te perdoret ne beton.

Agregati duhet te testohet per tu percaktuar ndonje reaksion alkaline-agregat. Guret e copetuar ose guret e copetuar pjeserisht jane burimi I agregatit.

Uji duhet te jete I paster pa permbajtje vajrash, acidesh, alkalinesh, kriprash ose material organike apo material te tjera te demshme.

Perzierja nuk duhet te permbaje jone kloruri ne sasi qe mund te shkaktojne ne permbajtjen totale te klorurit ne beton qe te tejkalojne 0.4 pound per meter kub

Vetite mekanike te celikut te paratensionuar, , celik I perforcuar dhe perforcimet spirale duhet te jene ne perputhje me standartet e perdorura.

#### **9.4.8 Tokëzimi i shtyllave**

Do të përdoret nje percjelles tokezimi i brendshem . Per lidhjen e percjellesit te tokezimit te shtylles me tokezimin e jashtem do te perdoren elemente te filetuar nga brenda(dado), pozicioni i te cileve ne shtylle tregohet ne vizatimet perkatese dhe sqarohet me poshte.

Fija e celikut e perfshire ne lidhje do te jete tokezimi i brendshem i shtylles. Minimumi nje percjelles celiku gjatesor (me diameter jo me te vogel se 12 mm) do te lidhet elektrikisht me elementet prej bronzi(dado bronzi M12) te filetuar nga brenda, te cilet jane vendosur ne maje dhe ne fund te shtylles.

